



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 75

4 korrik

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 380, datë 6.6.2012	Për miratimin e profilit kombëtar të zgjeruar të migracionit, për vitin 2010	3459
Vendim i KM nr. 409, datë 27.6.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Denas” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	3520

VENDIM
Nr. 380, datë 6.6.2012

**PËR MIRATIMIN E PROFILIT KOMBËTAR TË ZGJERUAR TË MIGRACIONIT, PËR
VITIN 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e profilit kombëtar të zgjeruar të migracionit, për vitin 2010, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Instituti i Statistikave për botimin e këtij profili në faqet zyrtare të institucioneve në internet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROFILI KOMBËTAR I ZGJERUAR I MIGRACIONIT PËR VITIN 2010

Ky dokument prezanton “Profilin kombëtar të zgjeruar të migracionit” në Republikën e Shqipërisë të vitit 2010. Hartimi dhe publikimi i tij është miratuar me urdhrin nr. 90, datë 28.10.2011 të Kryeministrit. Informacioni i mbledhur dhe analiza e të dhënave për përgatitjen e këtij profili është siguruar nga burime zyrtare. “Profili i zgjeruar i migracionit” i viti 2010 gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Ministrave, si dhe të institucioneve përgjegjëse për hartimin e tij.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij dokumenti nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në asnjë formë apo mënyrë elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjen, regjistrimin pa të drejtën e autorëve. Materiali është publikuar me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e grupit ndërministror të punës.

Hartimi dhe publikimi i “Profilit të zgjeruar të migracionit” i vitit 2010, është financuar nga Qeveria Shqiptare.

Në hartimin e këtij “Profili të zgjeruar mbi migracionin” dhanë kontribut IOM Tirana, Zyra e UNHCR-së në Tiranë, prezenca e OSBE-së në Tiranë dhe ICMPPD-ja.

Profili Kombëtar Vjetor i Migracionit

Ministria e Brendshme

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Ministria e Punëve të Jashtme

Ministria e Financave

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës



Instituti i Statistikave
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
INFORMACION I PËRGJITHSHËM¹



Kryeqyteti: Tirana

Sipërfaqja e përgjithshme: 28,748 km² (tokë: 27,398 km², ujë: 1,350 km²)

Kufiri: Gjatësia e përgjithshme: 1079 km (tokësor: 717 km; detar: 362 km;

Shtetet kufitare: Mali i Zi 151 km, Kosovë 112 km, Maqedoni 172 km, Greqi 282 km)

Popullsia: Popullsia shqiptare e regjistruar: 4 247 426; dendësia: 151.6/km²

Gjuha: Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe. Në territoret e banuara nga minoritetet, përveç gjuhës shqipe flitet dhe gjuha greke, serbo-kroate dhe maqedonase.

Presidenti: Bamir Topi

Kryeministri: Sali Berisha

Qeverisja: Republikë parlamentare

HYRJE

Migracioni përbën një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me vendet fqinje, vendet anëtare të Bashkimit Europian e më gjerë, si dhe një angazhim serioz në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian.

Menaxhimi i flukseve migratore, fokusuar kryesisht në hartimin dhe përditësimin e profileve të migracionit, është jo vetëm një tregues i menaxhimit bashkëkohor të migracionit, por dhe një kontribut në informimin publik mbi situatën migratore në vend.

¹ Harta: CIA World Facts Book.

https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/maps/maptemplate_al.html.

Profilat e migracionit, të hartuara në vitet 2007 dhe 2008 nga organizatat ndërkombëtare, krahas informacionit me rëndësi që paraqisnin në këto profile, kishin dhe informacion të pasaktë apo ishin prezantuar me mungesë informacioni, gjë e cila shtrembëronte apo nuk e paraqiste siç duhej realitetin mbi migracionin në Shqipëri.

Gjithashtu, profili i migracionit i vitit 2009, i hartuar kryesisht nga strukturat e Ministrisë së Brendshme, megjithëse ishte një variant më i plotësuar, përsëri kishte mangësi, për sa i përket informacionit që duhej të përmbante nga fusha të tjera, që kanë ndikim mbi migracionin.

Për herë të parë, strukturat shtetërore përgjegjëse për monitorimin e flukseve migratore, në bashkëpunim me struktura të tjera që kontribuojnë në fushën e migracionit në Shqipëri, si ato qeveritare dhe joqeveritare hartojnë një “Profil të zgjeruar mbi migracionin”.

Migracioni është një dukuri shumëdimensionale, e përbërë nga shumë elemente dhe komponentë, në menaxhimin e të cilave janë të angazhuara direkt apo indirekt një numër i konsiderueshëm i institucioneve shtetërore, por dhe shumë organizata ndërkombëtare, si dhe ato vendase joqeveritare.

Në kuadër të nismave rajonale apo atyre europiane dhe më gjerë për ndërtimin e partneriteteve mbi migracionin, përgatitja dhe publikimi i profileve të migracionit është një kontribut i domosdoshëm. Nëpërmjet këtyre publikimeve, vendet e përfshira në këto nisma do të arrijnë të grumbullojnë të dhënat zyrtare mbi emigracionin e shtetasve të tyre në Republikën e Shqipërisë.

Për t’iu përgjigjur natyrës shumëdimensionale të migracionit, aktivitetet të zgjeruara të shumë strukturave në menaxhimin e migracionit apo atyre që kanë impakt me fushën e migracionit, nevojitet përgatitja e “Profilit të zgjeruar mbi migracionin”.

Profilat e zgjeruara mbi migracionin synojnë të paraqesin situatën mbi migracionin në periudha relevante së paku njëvjeçare, por në varësi të flukseve migratore apo ndryshimeve të situatave migratore mund të përgatiten dhe publikohen dhe për periudha më të shkurtra kohore.

Përgatitja e “Profilit të zgjeruar mbi migracionin” përmban në vetvete jo vetëm të dhëna statistikore, por një analizë të gjithanshme të situatës migratore.

Pjesa A e “Profilit të zgjeruar të migracionit” synon të përshkruajë se si ka evoluar migracioni gjatë viteve. Për më tepër, ai jep një përmbledhje të shkurtër të trendeve dhe çështjeve kryesore në dekadën e fundit. Pjesa B jep një pasqyrë të kushteve socio-ekonomike të vendit në mënyrë për të kuptuar faktorët e mundshëm shtytës dhe tërheqës, që ndikojnë te migracioni. Pjesa C analizon nga njëra anë modelet e migracionit dhe trendet më të fundit dhe, nga ana tjetër siguron një pasqyrë të të dhënave ekzistuese të numrit dhe tipave të imigrantëve/emigrantëve të rregullt, imigrantëve/emigrantëve të parregullt, informacion lidhur me diasporën jashtë, si dhe remitancat (dërgesat). Pjesa C, gjithashtu, identifikon të dhënat e munguara.

Bazuar në të dhënat e pjesës A, B dhe C, pjesa D përmbledh trendet kryesore të migracionit, duke përcaktuar faktorët kryesorë shtytës dhe tërheqës, që kanë ndikuar mbi migracionin. Për më tepër është hulumtuar mbi lidhjen ndërmjet faktorëve të ndryshëm demografikë dhe socio-ekonomikë dhe ndikimet e tyre te migracioni, në zhvillimin socialo-ekonomik dhe në efektivitetin e politikave të migracionit të lidhura me to.

Gjetjet dhe analizat kryesore janë prezantuar në pjesën H të këtij profili. Në pjesën H tregohen mangësitë e të dhënave ekzistuese dhe strategjitë e mundshme për përmirësimin e të dhënave mbi migracionin. Gjithashtu, jepen sugjerime për bërjen e profilit të migracionit më të përditësueshëm, jepen rekomandimet kryesore për politikëbërësit për përmirësimin e menaxhimit aktual të migracionit.

A. PARATHËNIE

A.1 Modelet e fundit të migracionit. Një përmbledhje e shkurtër

Shqipëria është një vend me një popullsi të regjistruar me mbi 4 milionë banorë. Krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullsisë, Shqipëria ka aktualisht përqindjen më të lartë të



emigracionit në Europën Qendrore dhe Lindore. Megjithëse nuk ka statistika të sakta mbi emigracionin, përllogaritet se rreth 25% e popullsisë shqiptare banojnë jashtë vendit. Nga ana tjetër, imigracioni zë një përqindje të vogël (rreth 0.2% të popullsisë totale që banojnë në Shqipëri) dhe bazohet kryesisht në imigrimin për motive punësimi. Përveç imigrantëve për qëllime punësimi, gjatë vitit të fundit është rritur përqindja e tyre për qëllime të ribashkimit familjar apo për qëllime studimi. Ndërkohë, vihet re një ulje e numrit të të huajve rezidentë për aktivitete humanitare.

Historia e migracionit shqiptar fillon që në kohërat e hershme të pushtimit të Perandorisë Otomane Turke, vazhdon gjatë periudhës së krijimit të shteteve të Europës Juglindore në fund të shekullit XIX e fillim të atij XX, për të vazhduar në përmasa të konsiderueshme në vitet 1991, 1997 e 1998 dhe mund të grupohet kështu sipas periudhave të zhvillimit:

- në atë të hershëm apo para luftërave deri në vitin 1944;
- në migracionin e periudhës së regjimit komunist, 1944-1990;
- në atë postkomunist 1990 e në vazhdim.

Lëvizjet migratore shqiptare të periudhës së pushtimit otoman, kryesisht drejt Italisë, shënojnë shpërnguljet më të mëdha të hershme të popullsisë shqiptare. Më pas, Lufta II Botërore pati një ndikim në lëvizjet çame nga Greqia drejt Shqipërisë, sidomos pas marrëveshjes së Lozanës më 1923 në mes Greqisë e Turqisë për shkëmbimin e popullsisë.

Gjatë viteve të regjimit komunist 1944-1990 emigracioni shqiptar përbëhej nga individë, të cilët largoheshin nga Shqipëria për motive politike dhe janë vendosur në vende të ndryshme si azilkërkues politikë. Pas ndryshimit të regjimit në vitin 1990, Shqipëria kaloi një periudhë të vështirë dhe të gjatë transicioni, gjë që nxiti në mënyrë të menjëhershme emigracionin. Me gjithë rritjen ekonomike dhe stabilitetin politik gjatë viteve 1992-1996, fluksi i emigrantëve mbeti i pandryshuar, duke përfshirë këtu edhe emigrantë të kualifikuar.

Problemet sociale nga skemat piramidale të vitit 1997, si dhe më pas trazirat e vitit 1998 u shoqëruan me një numër të madh emigrantësh shqiptarë drejt vendeve të BE-së.

Spastrimi etnik serb në Kosovë në vitin 1998 detyroi të hynin në Shqipëri mijëra shtetas kosovarë dhe të kërkonin mbrojtje të përkohshme.

Me fillimin e mijëvjeçarit të ri, modelet e migracionit dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj tij kanë ndryshuar. Kjo në sajë të politikave shtrënguese të vendeve pritëse dhe nga ana tjetër, e fillimit të reformave në Shqipëri dhe intensifikimit të luftës kundër formave të migracionet të paligjshëm në përgjithësi, si dhe kalimit të kufirit në mënyrë të paligjshme në veçanti. Gjatë viteve të fundit, prirja e emigracionit shqiptar është zhvendosur nga vendet fqinje në drejtim të vendeve, si: Mbretëria e Bashkuar, Kanada dhe SHBA, ku ekzistojnë perspektiva ekonomike më të mira dhe mundësi për emigracionin e ligjshëm apo legalizim.

Së bashku me emigracionin masiv nga Shqipëria për në vendet e tjera, migracioni i kthimit për në Shqipëri, ka njohur zhvillim që varion nga kthim vullnetar, në atë të detyruar. Një pjesë e rikthimeve në Shqipëri nga viti 2001-2004 është bërë, mbështetur në programin e IOM-it për “Kthim vullnetar të asistuar”.

Përgjithësisht, Shqipëria mund të konsiderohet si një vend origjine i emigracionit, si vend që është tentuar të jetë vend transit i emigracionit të paligjshëm, por dhe si vend destinacioni i imigracionit.

Emigracioni i paligjshëm shqiptar më shumë është zhvilluar drejt vendeve fqinje, si: Greqia (98%) dhe Italia, por dhe vende të tjera të BE-së, si: Gjermania, Franca, Belgjika, Holanda etj.

Emigracioni transit në vitet 2007, 2008 dhe 2009 ka shënuar shifrat rekord deri të pakonsiderueshme (2007 = 0 raste, 2008 = 1 rast dhe 2009 = 2 raste), ndërsa në vitin 2010 ka tentuar të shfaqet në dy forma të zhvillimit të tij, atë të hyrjes në mënyrë të ligjshme e, më pas, transitimin drejt vendeve të tjera (kryesisht shtetas turq), por dhe me anë të hyrjes në mënyrë të

paligjshme në Shqipëri dhe, më pas tentimin për të transituar po në mënyrë ilegale nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë drejt vendeve të tjera të rajonit e me destinacion final vendet e BE-së (kryesisht shtetas nga Afganistani, Palestina, Tunizia, Maroku, Algjeria etj.).

Si vend destinacioni i imigracionit, Shqipëria vitet e fundit, gjithashtu, ka njohur formën e imigracionit të paligjshëm dhe atë të ligjshëm.

Imigracioni i paligjshëm në vitet 2007, 2008 dhe 2009 është zhvilluar kryesisht nëpërmjet hyrjes së ligjshme dhe, më pas qëndrimit të paligjshëm. Në vitin 2010, shënohet një tendencë në rritje e hyrjes në mënyrë të paligjshme dhe, më pas qëndrimin në mënyrë të paligjshme.

Rritja e numrit të rasteve të zbuluara të imigracionit të paligjshëm pasqyron në fakt më shumë efektivitetin e masave të marra për zbulimin e imigracionit të paligjshëm se sa një rritje të ndjeshme të këtij imigracioni. Ndërsa në vitin 2010, kjo rritje ka ardhur si pasojë e përballjes me flukset e para migratore të shtetasve të vendeve të Afrikës nga Greqia drejt vendeve të tjera të BE-së, duke tentuar transitimin edhe nëpërmjet Shqipërisë.

Imigracioni i ligjshëm është zhvilluar kryesisht për motive punësimi, bashkimi familjar, por dhe për motive të tjera, si ato për studime apo të aktiviteteve humanitare dhe fetare. Në vitin 2010 vihet re një rritje e numrit të imigrantëve të ligjshëm për motive studimi, si dhe një ulje e numrit të imigrantëve të përfshirë në aktivitete fetare dhe humanitare.

Sipas statistikave të disponueshme rezulton se numri më i madh i imigrantëve të ligjshëm ka qenë në vitin 2009, kur ishin regjistruar përafërsisht 8000 imigrantë (30% e tyre nga Turqia). Pas kësaj kohe numri i imigrantëve ka pasur një ulje përkatësisht në rreth 7500.

Situata mbi imigracionin e ligjshëm në vitet e fundit, mbështetur në të dhënat statistikore, paraqitet më konkretisht: më 1 janar të vitit pasardhës, rezulton të kenë përfituar statusin e rezidentit, përafërsisht: për vitin 2006: 3000 të huaj; për vitin 2007: 4000 të huaj; për vitin 2008: 5500 të huaj; për vitin 2009: 6700 të huaj; për vitin 2010: 5600 të huaj. Megjithatë, përqindja e emigrantëve në raport me popullsinë vendase është akoma shumë e ulët, krahasuar me shtetet e tjera të BE-së dhe të rajonit, e vlerësuar rreth 0.2 në 2010².

Referuar vendeve kryesore të origjinës, më 2008-ën, 2/3 e të huajve që jetojnë në Shqipëri vinin nga këto vende: Turqia (43%), Kina (12%), Italia (12%), SHBA (8%) dhe Kosovë-Maqedoni (6%). Një përqindje e konsiderueshme e imigrantëve ishin shtetas turq (motiv punësimi), ndërsa ata me origjinë aziatike ishin kryesisht kinezë. Të dhënat statistikore më të fundit tregojnë se numri i emigrantëve të ligjshëm pati rritje më 2009-ën, po ashtu për shkak të investimeve të huaja në vend. Kërkesat për marrjen e shtetësisë Shqiptare janë bërë kryesisht nga shtetas me etni shqiptare.

Lidhur me moshën, në vitet 1990-2008, shumica e të huajve që jetonin në Shqipëri ishin të grup-moshës 30-50 vjeç. Vërehet në dy vitet e fundit një rritje e grup-moshës 25-30 vjeç. Lidhur me gjininë e shtetasve rezidentë, vërehet se dominon gjinia mashkullore. Nisur nga statistikat, vërehet një rritje e përqindjes së femrave nga 18% në 32% të numrit të përgjithshëm të shtetasve të huaj rezidentë për vitin 2010.

B. ANALIZA E STRUKTURËS SOCIAL-EKONOMIKE TË MIGRACIONIT

B.1 Ndryshimet demografike

Duke analizuar popullsinë shqiptare të regjistruar sipas “Regjistrit kombëtar të gjendjes civile”, struktura demografike rezulton si në vijim.

² Të dhënat u referohen statistikave vjetore të sektorit të migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin të Ministrinë së Brendshme.



Ndarja e popullsisë së regjistruar sipas qarqeve

Qarku	1 janar 2009	1 nëntor 2009	1 nëntor 2010	Rritja e popullsisë
Berat	235,726	229,299	230,655	1%
Dibër	187,128	179,021	179,921	1%
Durrës	404,110	401,591	409,245	2%
Elbasan	426,682	420,282	426,140	1%
Fier	488,181	480,280	485,549	1%
Gjirokastër	163,414	155,028	156,098	1%
Korçë	356,208	348,074	351,692	1%
Kukës	116,300	107,643	109,187	1%
Lezhë	214,147	208,719	211,762	1%
Shkodër	338,598	327,196	330,853	1%
Tiranë	992,360	967,958	989,682	2%
Vlorë	373,123	366,975	372,646	2%
Total	4,295,977	4,192,066	4,253,430	1%

Pas muajit janar 2009, si rezultat i ngritjes së “Regjistrit kombëtar të gjendjes civile”, janë ekzekutuar procedura pastrimi dublimesh në bazë të informacionit të marrë nga zyrat e gjendjes civile. Ndërkohë, gjatë periudhës në vijim, janë bërë pastrime ose çregjistrime të personave me moshë mbi 100 vjeç apo të atyre që kanë lënë shtetësinë dhe ndodheshin në sistem. Kjo shpjegon dhe rënin e numrit të popullsisë nga muaji janar në muajin nëntor 2009.

Si rezulton dhe nga të dhënat e tabelës, gjatë periudhës 1-vjeçare (nëntor 2009-nëntor 2010), vërehet një rritje e numrit të popullsisë së regjistruar me shtetësi shqiptare rreth 1%.

Popullsia e regjistruar në fund të vitit 2010, ndarë sipas gjinisë dhe grup-moshave:

Qarku	Përqindja sipas gjinisë		Përqindja sipas grup-moshave		
	Femra	Meshkuj	0-14	15-64	Mbi 64
Berat	48.71	51.29	19.74	72.23	8.03
Dibër	48.93	51.07	23.71	68.66	7.63
Durrës	49.02	50.98	21.16	70.97	7.87
Elbasan	48.98	51.02	21.52	71.11	7.37
Fier	48.42	51.58	19.82	71.98	8.20
Gjirokastër	48.92	51.08	16.74	71.56	11.69
Korçë	49.33	50.67	18.46	70.96	10.58
Kukës	49.47	50.53	24.55	67.00	8.45
Lezhë	48.92	51.08	21.73	70.53	7.74
Shkodër	49.09	50.91	20.45	70.10	9.44
Tiranë	49.62	50.38	19.56	71.65	8.80
Vlorë	48.97	51.03	18.42	72.62	8.97

Struktura demografike e popullsisë efektive në Shqipëri, sipas publikimeve të INSTAT-it, ku si referencë janë marrë të dhënat e vitit 2001 dhe studimet në vazhdimësi, rezulton se struktura e popullsisë (rezidente në Shqipëri) paraqitet si më poshtë:

- Volumi i popullsisë:

Vitet	2007	2008	2009	2010
Popullsia në fillim të vitit	3152.6	3170.0	3193.9	3195.0
Meshkuj	1582.3	1593.0	1592.4	1605.7
Femra	1570.3	1577.0	1601.5	1589.3

Popullsia rezidentet në Shqipëri është pak më shumë se 3 milionë banorë dhe ka një rritje relativisht të vogël, e cila nga viti në vit zvogëlohet (nga 0.005% për vitin 2007 në 0.0003% për vitin 2010). Raporti në mes numrit të përgjithshëm të shtetasve shqiptarë të regjistruar së bashku me të huajt rezidentë në Shqipëri me numrin e popullsisë rezidente të përllogaritur në Shqipëri, tregon pak a shumë numrin e shtetasve shqiptarë rezidentë jashtë vendit apo në emigracion, që përllogaritet rreth 1.2 milionë. Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 do të japë një panoramë më të saktë të situatës lidhur me këto shifra.

- Shpërndarja e popullsisë sipas moshës për popullsinë që banon më 1 janar (sipas gjinisë)³

Mosha	2007	2008	2009	2010
0-14 vjeç	783522.6	767449	756036.7	738829
15-64 vjeç	2091036	2113452	2139428	2096685
Mbi 60 vjeç	278066.5	289149	298385.7	359458
Totali	3152625	3170050	3193850	3194972

- Dendësia e popullsisë

VITET	2007	2008	2009	2010
Dendësia (%)	109.7	110.3	111.1	111.1

- Shkalla e urbanizimit sipas vendbanimit më 1 janar (sipas gjinisë dhe moshës)⁴

Vendbanimi	2007	2008	2009	2010
Tirana dhe qytetet e tjera	1544.5	1541	1557.3	1589.6
Fshatrat	1608.1	1629.0	1636.6	1605.4
Totali	3152.6	3170.0	3193.9	3195.0

Indeksi sintetik i fekonditetit (TFR)

VITET	2006	2007	2008	2009
Fertiliteti Total	1.4	1.3	1.4	1.1

Për vitin 2010 ky tregues nuk është përllogaritur për shkak të mungesës së skedave.

³ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.1 të këtij materiali.

⁴ Të dhënat mbi popullsinë në vitet 1995 - 2010 është llogaritur nga INSTAT-i, bazuar në projeksionet e regjistrimeve të vitit 1989 dhe 2001.



- Jetëgjatësia
Për vitet 2005-2010, në Shqipëri është përlogaritur një jetëgjatësi mesatare 75 vjeç, e cila varion:

Për meshkuj – 73 vjeç;

Për femra – 78 vjeç.

- Shtetas të huaj rezidentë, sipas shtetësisë:

Vitet	2007	2008	2009	2010
Europa (nga të cilët):	2894	4298	5007	4114
Vendet e BE-së	1080	1182	1324	1572
Turqi	1396	2573	2946	1648
Vendet e rajonit ⁵	148	355	395	779
Të tjera	270	188	342	115
Azia	497	819	1046	731
Nga të cilët: Kina	276	588	786	381
Amerika	548	558	480	623
Nga të cilët: SHBA	451	448	447	463
Afrika	140	131	152	187
Totali	4086	5812	6793	5663

- Tabela përmbljedhëse e migracionit

Viti	Imigrantë	Emigrantë	Diferenca në migrim	Shtetasit e huaj rezidentë në Shqipëri (1janar)	
				Numri	% e totalit të popullsisë
2006	3111	Mungojnë të dhënat	-	3111	0.99
2007	4086	Mungojnë të dhënat	-	4086	1.30
2008	5807	Mungojnë të dhënat	-	5807	1.83
2009	6793	Mungojnë të dhënat	-	6793	2.13
2010	5663	Mungojnë të dhënat	-	5663	1.77

- Përfitimi dhe lënia e shtetësisë

Sipas statistikave të Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme rezulton se gjatë vitit 2010 janë regjistruar:

- 370 aplikime për lënie të shtetësisë shqiptare;
- 95 aplikime për fitimin e shtetësisë shqiptare;
- 42 aplikime për rifitimin e shtetësisë shqiptare.

B.2 Ekonomia dhe klima ekonomike

- Indikatorët kryesorë makroekonomikë:

GDP-ja reale dhe GDP-ja për frymë

⁵ Rajoni përfshin vendet e Ballkanit Perëndimor: Mali i Zi, Kosovë, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Bosnjë-Hercegovinë.
3466

Viti	GDP (në miliard ALL)	GDP indeks i vëllimit (viti paraardhës = 100) in%	Për frymë GDP në vlerën aktuale në USD
2008	1,089.3	7.5	4,098.6
2009	1,151.0	3.3	3,804.9
2010	1,231.1	3.8	3,707.9

- Shkalla e zhvillimit të sektorëve në milion ALL (treguesi i volumit, viti paraardhës = 100)

Viti	Bujqësi, pyje, peshkim	Industri (nxjerrëse dhe përpunuese)	Ndërtim	Shërbime
2008	7.3	9.4	10.7	6.7
2009	3.3	0.6	0.2	5.3
2010	6.4	23.1	-18.5	6.0

- Shkalla e inflacionit

2008: 3.4%

2009: 2.3%

2010: 3.6%

- Debiti publik (në% të PBB-së)

2008: 54.7%

2009: 59.3%

2010: 58.1%

- Investimet e kapitalit⁶

Treguesit në vlerë dhe volum të investimeve në ekonominë kombëtare:

Viti	Shpenzimet kapitale (çmimi aktual), mln ALL	Shpenzimet kapitale Norma e rritjes nominale (%)	Shpenzimet kapitale (në% të GDP)
2008	93,783	64.4	8.6
2009	95,881	2.2	8.3
2010	67,492	-29.6	5.5

- Investimet direkt të huaja

Viti	Investimet e ndërmarrjeve FDI (milion euro)
2008	653
2009	705
2010	827

⁶ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.2 të këtij materiali.



- Sektorët kryesorë të punësimit⁷, fuqia punëtore

Të punësuar:	Viti 2009			Viti 2010			
	TM-II	TM-III	TM-IV	TM-I	TM-II	TM-III	TM-IV
Fuqi punëtore	1,114,116	1,113,580	1,042,618	1,045,261	1,049,491	1,059,199	1,059,959
Të punësuar gjithsej nga të cilët:	972,831	971,518	899,278	900,653	904,850	915,981	916,919
Në sektorin publik	166,453	166,453	166,250	166,250	166,500	166,600	166,000
Në sektorin privat joagrar	237,829	236,516	236,838	238,213	242,160	242,717	244,255
Në sektorin privat agrar ⁸	568,549	588,549	496,190	496,190	496,190	506,664	506,664

- Tregu-Bilanci i tregut: importet dhe eksportet⁹

Bilanci i tregut shqiptar sipas grupeve në Europë dhe botë (në mln lekë)

Viti	Bashkimi Europian (EU-27)	Të tjera jo EU	Totali	Afrika	Amerika	Azia	Australi Oqeani	Të tjera
Importe								
2008	259899	90255	350154	3313	15662	69416	307	1041
2009	272302	77804	350106	3161	14573	62054	256	957
2010	292625	84547	377172	2715	14731	63081	226	504
Eksporte								
2008	89513	17987	107487	62	451	4453	1	118
2009	81627	14365	95992	772	982	5392	3	103
2010	112963	32896	145859	1746	2755	10550	0	52
Bilanci								
2008	-170385	-72268	-242667	-3250	-15212	-64963	-306	-923
2009	-190675	-63439	-254114	-2389	-13591	-56662	-253	-854
2010	-179662	-51651	-231313	-969	-11976	-52531	-226	-452

⁷ Burimi: INSTAT-i (Instituti i Statistikave).

⁸ Numri mesatar i të punësuarve në sektorin privat agrar nga tremujori II- 2008 deri në tremujorin III- 2009, është vlerësuar nga studimi i fuqisë punëtore 2007. Nga tremujori IV-2009 deri në tremujorin II - 2010 është vlerësuar nga studimi i fuqisë punëtore 2008 dhe nga tremujori III - 2009 është vlerësuar nga studimi i fuqisë punëtore 2009.

⁹ Burimi: INSTAT-i (Instituti i Statistikave).

Indeksi i çmimit të konsumatorit për grupet kryesore (viti i mëparshëm = 100.0)¹⁰
B.3 Analiza e tregut të punës

Viti	Ushqim, pije joalkoolike	Pije alkoolike, Duhan	Veshje dhe këpucë	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	Të tjera	Mallra dhe shërbime të ndryshme	Totali
2008	100.9	100.7	96.5	103.3	100.1	100.4	100.4	101.1
2009	105.9	104.2	94.6	105.1	100.5	101.2	101.2	103.4
2010	111.4	109.9	93.2	108.9	101.0	102.9	102.9	107.1

B.3.1 Zhvillimet më të fundit të tregut të punës në vend

- Ligji i punës dhe politikat e punësimit

Ligji nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” parashikon si grupe të veçanta emigrantët që kthehen me probleme ekonomike. Në vitin 2010 u bënë ndryshimet përkatëse në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 18.9.2003 “Për nxitjen e punësimit të punëkërkuësve të papunë femra” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 16.1.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi”, për të përfshirë në këto dy programe nxitje punësimi grupet e emigrantëve që kthehen me probleme ekonomike. Sipas këtyre programeve nxitja është në formën, pagesës nga zyrat e punësimit të sigurimeve të detyrueshme që duhet të paguhet nga punëdhënësi, si dhe disa pagave për një kohë të përcaktuar nga të dyja vendimet e Këshillit të Ministrave të sipërpërmendura. Kështu, mbështetja që nga viti 2010, përveç grupeve të punëkërkuësve të papunë, si ata që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, punëkërkuës mbi 45 vjeç, femra mbi 35 vjeç, vajzat nëna, romët, personat me aftësi të kufizuar, janë përfshirë dhe emigrantët me probleme ekonomike. Programet financohen çdo vit nga Buxheti i Shtetit.

Gjithashtu, si grupe të veçanta të emigranteve me probleme ekonomike përfitojnë falas formim profesional në 10 qendrat e formimit profesional publik, ku ofrohen disa profesione, të cilat janë të kërkuara nga tregu i punës, si: autoservis, mobilieri, hidraulikë/hidrosanitarë, kuzhinë, panele diellore, elektrike, riparim elektro-shtëpiake, specialitete të ndërtimit, riparim kondicionerë, duralumin, ngrohje-ventilim, operator social, bebisiter.

- Sistemi i sigurisë sociale

Në vitin 2010, 98 mijë familje kanë përfituar pagesën e ndihmës ekonomike. Numri i fëmijëve të familjeve të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike është 190 mijë, prej të cilëve 80 mijë ndjekin arsimin në shkollat përkatëse.

Në kuadër të reformës së shërbimeve shoqërore, procesi i decentralizimit dhe deinstitutionalizimit do të vijojë me modele të reja rajonale sipas politikave bashkëkohore europiane.

- Ndryshimet në sistemin e pensioneve

Politikat për pensionet janë fokusuar në dy drejtime kryesore:

- Në përmirësimin e legjislacionit të sigurimeve shoqërore e përafrimin me atë të BE-së, si dhe në rritjen e vazhdueshme të pensioneve;

- Në rritjen e vazhdueshme të masës së pensioneve në funksion të plotësimit më të mirë të nevojave të pensionistëve.

Në këtë mënyrë rritet aftësia vetëmbajtëse e skemës së sigurimeve shoqërore, duke ulur subvencionin e Buxhetit të Shtetit.

¹⁰ Burimi: INSTAT-i (Instituti i Statistikave).



Rritjet e pensioneve në përgjithësi janë realizuar nëpërmjet zbatimit të politikave të qeverisë dhe angazhimit të strukturave të saj, për uljen e evazionit kontributiv dhe informalitetit në ekonomi. Gjatë këtyre viteve u bë e mundur ulja e ngarkesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 38.5% në 29.5%, duke favorizuar në këtë mënyrë zhvillimin e biznesit dhe nxitjen e tyre në shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit. Duke filluar nga 1 maji 2009 kontributet e sigurimeve shoqërore u ulën me 5 pikë, pra nga 29,5% u bënë 24,5%. Pjesa prej 5 pikësh ulet nga pjesa e kontributit të punëdhënësit. Reduktimi i normës së kontributeve ka ndikuar pozitivisht në uljen e informalitetit, rritjen e numrit të kontribuesve dhe, për rrjedhojë, edhe në rritjen e të ardhurave të kontributeve.

Në funksion të përmbushjes së nevojave të pensionistëve, në fund të viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009 janë zbatuar vendime për asistencën ekonomike të pensionistëve (shpërblimi i fundvitit) nga i cili përfituan rreth 530 mijë persona. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2006 e në vazhdim, në dispozicion të ISSH-së janë vendosur fondet e nevojshme për kompensimin e pensionistëve dhe invalidëve, për shkak të ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike.

Pensionet janë pjesë e rëndësishme e mbështetjes sociale të moshës së tretë, të cilat jo vetëm që janë bazë për plotësimin e nevojave jetike të kësaj shtrese, por shërbejnë edhe si një faktor i rëndësishëm në uljen e varfërisë si në qytet ashtu edhe në fshat.

Në këtë këndvështrim qeveria ka pasur në qendër të vëmendjes politikatat për eliminimin çdo vit të gërryerjes së masës së pensionit nga inflacioni.

- Tabelë mbi nivelin e rritjes së pensioneve

Emërtimi	Njësia matëse (lekë/muaj)						Rritja/2005
	2005	2006	2007	2008	2009	2010	
Pensioni minimal, qytet	7850	8240	8650	9515	10276	10690	41.6%
Pensioni minimal, fshat	3430	4110	4520	5200	6344	6980	2.17 herë
Pensioni maksimal, qytet	15700	16480	17300	19030	20552	21380	41.6%
Të ardhura minimale në qytet	8350	10000	10410	11275	12226	12840	58.8%
Të ardhura minimale në fshat	3630	5000	5410	6090	7130	7870	2.3%
Paga minimale në shkallë vendi	11800	14000	16000	17000	18000	19000	69%

B.3.2 Punësimi i të huajve

- Treguesit sasiorë mbi lejet e punës

Janë pajisur me leje pune 1608 shtetas të huaj dhe janë përjashtuar nga detyrimi për pajisjen me leje pune 74 shtetas të huaj.

Lejet e punës lëshuar për shtetas të huaj nga DPSHKP-ja, zyrat rajonale dhe vendore të punësimit:

Lejet e punës të lëshuara për çdo 3-mujor 2010

Organi lëshues	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV	Totali 2010
Durrës	9	14	14	31	68
Elbasan	32	9	36	13	90
Fier	9	0	28	5	42
Shkodër	24	14	43	31	112
Tiranë	164	225	229	189	807

Tropojë	9	4	11	6	30
Të tjera	48	38	40	13	139
DPSHKP	57	43	151	69	320
Totali	352	347	552	357	1608

Sikurse shihet në tabelën më lart, janë pajisur me leje pune 1608 shtetas të huaj; numri më i madh i lejeve të punës është dhënë nga DRP-ja Tiranë, 807 leje pune, që përbën 50% të totalit, DPSHKP-ja me 320 leje pune, që përbën 20% të totalit, DRP-ja Shkodër me 102 leje pune, që përbën 7% të totalit të lejeve të punës.

Janë dhënë 7 refuzime nga DPSHKP-ja, 3 anulime dhe kanë rinovuar lejen e punës 141 shtetas të huaj.

- Tipi i lejeve të punës

Kategoria që paraqet shifrën më të lartë të shtetasve të huaj të pajisur me leje pune është ajo e punëmarrësve, 1252 leje A/P, që përbën 78% të totalit, më pas vjen ajo e të vetëpunësuarve me 129 leje pune ose 8% e totalit dhe ajo e të transferuarve brenda ndërmarrjes me 102 leje pune, që përbën 6% të lejeve të punës në total.

Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e lejeve të punës sipas tipit të lejeve të punës:

Tipi	A/P	A/TN	A/NK	A/AF	A/PS	A/S	B/VB	B/1	D	C	Tot.
Nr. i lejeve	1252	102	5	2	12	1	129	25	18	62	168

- Sektorët e aktivitetit

Në tabelën e mëposhtme jepet kategorizimi i lejeve të punës për sektorët e aktivitetit, ku shtetasit e huaj janë më të punësuar.

Sektor i aktivitetit	Nr. LP
Industri nxjerrëse	150
Shëndeti dhe veprimtari sociale	115
Shërbime kolektive, sociale dhe personale	236
Tregtia dhe riparim automjetesh	228
Ndërtim	259
Arsim	152
Të tjera	454
Totali	1594

Sektorët më të lëvruar të aktivitetit të shtetasve të huaj janë kryesisht sektori i ndërtimit, 259 leje pune (përbën 16% të totalit), shërbime kolektive sociale dhe personale 236 leje pune (përbën 15% të totalit), tregti dhe riparim automjetesh, 228 leje pune (përbën 14% të totalit), arsim, 152 leje pune dhe industri nxjerrës, 150 leje pune (përbëjnë 9% të totalit), shëndeti e veprimtari sociale që përbën 7% të numrit total të lejeve të punës.



- Kategorizimi sipas shtetësisë

Më poshtë jepet tabela e lejeve të punës, të lëshuara për shtetësitë kryesore

Shteti	Leje pune	Shteti	Leje pune
Turqi	567	Kroaci	39
Kinë	190	Serbi	30
Itali	139	Indi	29
Greqi	101	Amerikë	29
Maqedoni	61	Mal i Zi	23
Kanada	56	Gjermani	21
Kosovë	55	Egjipt	16
Filipine	54	Angli	14
Austri	41	Të tjera	129
Totali		1594	

Shtetasit e huaj që përbëjnë shifrën më të lartë në punësim në nivel kombëtar janë:

Turqit, 567 ose 35% e shtetasve të huaj në total;

Kinezët 190 ose 12% e totalit;

Italianët 139 ose 9% e totalit;

Grekët 101 ose 6% e totalit.

- Kategorizimi sipas gjinisë

Gjatë vitit 2010, numri i shtetasve të huaj të pajisur me leje pune zë 90% të numrit të përgjithshme të lejeve të lëshuara (1447 leje pune), ndërsa 10% të këtij numri e zënë femrat (161 leje pune).

B.3.3 Përjashtimet nga detyrimi për pajisje me leje pune

- Përjashtimi nga detyrimi i lejes së punës

Në zbatim të ligjit 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nga Drejtoria e Politikave të Migracionit janë shqyrtuar kërkesat e shtetasve të huaj për t’u përjashtuar nga detyrimi për t’u pajisur me leje pune. Në miratimin e kërkesave të paraqitura pranë kësaj drejtorie, janë zbatuar kriteret dhe afatet e parashikuara në legjislacionin përkatës. Referuar dokumentacionit që posedohet, rezulton se gjatë vitit 2010 janë miratuar gjithsej 74 përjashtime nga detyrimi për t’u pajisur me leje pune për shtetas të huaj, duke u pajisur me leje të tipit TP, si më poshtë:

Personat që janë pajisur me leje TP			
Punëmarrës	73	Fillestarë	66
Punëdhënës	1	Ripërtëritje	8
Totali		74	

Janë dhënë 66 përjashtime nga detyrimi për t’u pajisur me leje pune për shtetas të huaj, të cilët janë punëmarrës fillestarë dhe 8 ripërtëritje të lejes së punës.

- Tabela e lejeve sipas misionit apo sektorit të aktivitetit

Profesioni	Personat e punësuar
Punonjës shërbimi	45
Pilotë	5
Menaxher drejtues	1
Inxhinier	3
Ekonomist	1
Misionar fetar	11
Konsulentë	3
Drejtues ekzekutiv	1
Drejtues shoqate humanitare	2
Shef misioni të org. ndërkombëtare	2
Totali	74

Shumica e shtetasve të huaj, të përjashtuar nga detyrimi për pajisje me leje pune, janë punonjës shërbimi, që përbëjnë 60% të të përjashtuarve në total; më pas vijnë misionarët fetarë që përbëjnë 15% të totalit të të përjashtuarve.

- Lejet e punës për shtetasit e huaj sipas ndarjes territoriale

Të huajt që janë pajisur me leje të tipit TP janë të shpërndarë në disa qarqe të vendit, sipas tabelës së mëposhtme:

Vendbanimi i të huajve të pajisur me leje TP

Tiranë	65
Gjirokastrë	2
Shkodër	1
Tepelenë	1
Rrëshen (Mirditë)	3
Krujë	1

Sic vërehet dhe nga tabela, shtetasit e huaj që janë të përjashtuar nga detyrimi për leje pune, banojnë kryesisht në Tiranë.

- Sipas shtetësisë

Të huajt që janë përjashtuar nga detyrimi për t'u pajisur me leje pune janë kryesisht nga vendet joanëtare të BE-së. Kështu, nga 74 leje të miratuara vetëm 16 janë shtetas të vendeve të BE-së. Shumica e shtetasve të përjashtuar nga detyrimi për pajisje me leje pune janë azerbajxhanas, punonjës shërbimi në Tiranë¹¹.

- Ndarja e lejeve TP sipas gjinisë

Shtetas të huaj të pajisur me leje TP sipas gjinisë

Femra	20
Meshkuj	54
Totali	74

Sikurse shihet në tabelë, shumica e shtetasve të përjashtuar nga detyrimi për pajisje me leje pune janë meshkuj, që përbëjnë 73% të totalit.

¹¹ Shiko tabelat shtesë në aneksin II – I.2.3 të këtij materiali.



B.3.4 Treguesit cilësorë për lejet e punës për të huajt dhe përjashtimet

Nga vlerësimi analitik i të dhënave statistikore të mësipërme, rezultojnë këto karakteristikë dhe tendenca të fluksit të hyrjeve të shtetasve të huaj për qëllime punësimit:

- Duke krahasuar me vitin e kaluar, ka rritje të interesit të të huajve për të punuar dhe jetuar në Shqipëri në masën 17%.

- Shtetasit e huaj paraqesin interes më shumë në fushën e investimeve, të ndërtimit, të tregtisë dhe riparimit të automjeteve dhe në ndryshim nga viti i kaluar, vihet re rritje e fluksit të huajve në fushën e shërbimeve kolektive, sociale dhe personale dhe, më pas në arsim, industri nxjerrëse dhe shëndetësi, dhe veprimtari sociale.

- Rrethet ku është përqendruar pjesa më e madhe e të huajve që kryejnë aktivitet, janë: Tirana, Shkodra, Elbasani, Durrësi.

- Shtetasit e huaj që punojnë kryesisht në Shqipëri janë nga vende jo të BE-së, si ata me shtetësi turke dhe kineze etj. dhe, më pas vijnë ata nga Italia dhe Greqia, si vende të BE-së.

- Vihet re tendencë në rritje e shtetasve me statusin e punëmarrësit në masën 14% dhe që përbën numrin më të madh të të huajve të punësuar, si dhe një rritje e numrit të të vetëpunësuarve në masën 46% dhe të transferuarve brenda ndërmarrjes në masën 39%.

- Për sa i përket numrit të të huajve, të përjashtuar nga detyrimi për t'u pajisur me leje pune, në krahasim me vitin e kaluar, vihet re një tendencë në rritje e numrit të të huajve të interesuar në sektorët, që sipas ligjit për të huajt dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 6.3.2009, përfitojnë të drejtën e përjashtimit nga detyrimi për leje pune.

Në kuadrin e funksionimit të regjistrimit elektronik, moduli E-Leje pune, monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave mbi shtetasit e huaj që punojnë në Shqipëri, krijon mundësinë e studimeve të veçanta për të vlerësuar ndikimin e tyre jo vetëm në tregun shqiptar të punës, por edhe në kualifikimin e mëtejshëm të fuqisë punëtore shqiptare, që punon me këta shtetas të huaj dhe më gjerë, si dhe në jetën e tyre sociale.

B.3.5 Shkalla e papunësisë

Shkalla e papunësisë është një nga treguesit më të njohur të tregut të punës, i cili tregon përqindjen e personave të papunë ndaj popullsisë ekonomikisht aktive.

Nga viti 2000 deri më 2006 shkalla e papunësisë i referohej vetëm papunësisë së regjistruar. Nga nevoja për të pasur vlerësime sa më të sakta për këtë tregues të rëndësishëm, si social, ashtu dhe makroekonomik për një vend, si dhe për një përfaqësim sa më të mirë e të plotë të popullsisë në moshë pune në Shqipëri, në vitin 2007 u krye për herë të parë Anketa e Forcave të Punës (AFP), duke siguruar treguesit e papunësisë edhe nëpërmjet anketave pranë familjes. Për vitin 2009 shkalla e papunësisë matur nga AFP-ja ishte 13.8%.

Duke analizuar shkallën e papunësisë në vite, megjithëse diferenca në shkallën e papunësisë mes meshkujve dhe femrave ka ardhur duke rënë, tregu i punës në Shqipëri reflekton qartazi pabarazinë mes femrave dhe meshkujve. Kështu gjatë viteve 2000-2010, të dhënat administrative për papunësinë, tregojnë që kjo diferencë është mesatarisht 5%.


Nga burimet administrative për papunësinë, vihet re që numri i të regjistruarve si të papunë pranë zyrave të punës ka pasur një trend në rënie përgjatë viteve 2000-2010. Struktura e papunësisë, sipas nivelit arsimor të të papunëve të regjistruar, tregon se përqindjen më të lartë e zënë punëkërkuesit me arsim tetëvjeçar, pasuar nga punëkërkuesit me arsim të mesëm.

Nga analiza e strukturës së papunësisë sipas grup-moshave, përqindja e të papunëve të regjistruar të grup-moshës 35 vjeç e lart është më e lartë dhe ka një tendencë në rritje nga viti në vit. Ndërsa përqindja e të papunëve të regjistruar të grup-moshës 15-19 vjeç dhe 21-34 vjeç ka ardhur duke rënë.

Një tregues tjetër i tregut të punës është përqindja që zënë të papunët afatgjatë të regjistruar ndaj totalit të të papunëve të regjistruar. Për vitin 2000, të papunët afatgjatë përbënin 89.6% të totalit të të papunëve të regjistruar, ndërsa në vitet më pas deri në vitin 2010 kjo përqindje ulet deri në 62.5%.

Nga viti 2000 deri në 2010 vihet re që numri i të papunëve, që përfitojnë nga skema e pagesës së papunësisë ka ardhur duke rënë dhe shprehur në përqindje ky numër përbën mesatarisht 6.4% të totalit të të papunëve të regjistruar.

Shkalla e papunësisë së regjistruar, 2000-2010¹²



B.3.6 Niveli i të ardhurave¹³

Gjatë gjithë periudhës 1995-2009, vërehet një prirje në rritje e pagës mesatare mujore për një punonjës në sektorin shtetëror. Kjo nuk mund të thuhet për sa i përket prirjes në pagën reale, e cila është ndikuar nga luhatjet e inflacionit.

Gjatë periudhës 1995-1996, si rrjedhojë e qëndrueshmërisë së çmimeve të mallrave të ndryshme të konsumit dhe rritjes së pagave në sektorin shtetëror dy herë në vit, rritja e pagave ishte më e madhe se rritja e çmimeve. Kriza ekonomike që kaloi vendi ynë gjatë vitit 1997, solli si rrjedhojë uljen e ndjeshme të pagës reale, duke shënuar një rënie rreth 17% në krahasim me atë të një viti më parë.

Në vitin 1999, çmimet e konsumit pothuaj nuk ndryshuan fare dhe paga reale në fund të këtij viti shënoi rritje, rreth 10%. Një situatë e ngjashme vihet re edhe për vitin 2000, ku paga reale pësoi një rritje prej 17.7%.

Viti 2001 shënon një rritje të pagës mesatare mujore me 15.1%, ndërkohë që edhe çmimet e konsumit pësojnë rritje me rreth 3.1%, duke çuar në një rritje të pagës reale prej 11.6%. Në vitin 2003 rritja e pagës mesatare mujore është 8.5%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2.4%, duke sjellë rritje në pagën reale me 6%.

Në vitin 2004 rritja e pagës mesatare mujore është 9.9%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2.4%, duke sjellë rritje në pagën reale me 7.3%.

Në vitin 2007 rritja e pagës mesatare mujore është 17.1%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2.9%, duke sjellë rritje në pagën reale me 13.8%.

Duke vazhduar me një ulje të pagës reale në nivelin 6% në vitin 2008 dhe kjo për shkak të rritjes së pagës mesatare 8.3% dhe ndryshimit të çmimeve të konsumit 2.2%.

¹² Të dhënat nga publikimet e INSTAT-it.

¹³ Të dhënat nga publikimet e INSTAT-it.



Në vitin 2009 rritja e pagës mesatare mujore prej 11.9% dhe rritja e çmimeve të konsumit me 3.5% ndikuan në rritjen e pagës reale në 8.1%.

B.4 Kapitali njerëzor

- Niveli i edukimit

Shkalla e regjistrimit në edukimin primar dhe sekondar

Viti shkollor	Cikli i ulët-First stage		Cikël i Lartë- Second Stage		Gjithsej Total	Femra Female
	Gjithsej Femra		Gjithsej Femra			
2005-06	213751	103153	236951	114797	450702	217950
2006-07	210125	101018	237177	114671	447302	215689
2007-08	199454	95453	228981	110855	428435	206308
2008-09	236102	112399	221784	107807	457886	220206
2009-10	224781	106917	215214	104225	439995	211142

Shkalla e regjistrimit me edukim tretësor¹⁴

Universitete dhe fakultete	Gjithsej		Sistemi i ditës	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Studentë gjithsej, nga këta:	95449	54030	76147	43867
Universiteti i Tiranës	32884	22473	24747	17997
Universiteti Politeknik	9812	2743	9079	2599
Universiteti Bujqësor	9350	3399	7192	2665
Universiteti Elbasan	9547	6375	6763	4705
Universiteti Shkodër	12195	7361	9315	5572
Universiteti Gjirokastrë	3723	1927	2557	1333
Universiteti Korçë	4028	2319	3174	1892
Universiteti Vlorë	7659	4392	7144	4088
Akademia e Arteve	973	390	973	390
Akademia e Edukimit Fizik	772	127	697	102
Universiteti Durrës	4506	2524	4506	2524

Shkalla e edukim të popullsisë shprehur në përqindje¹⁵

Sipas nivelit arsimor				
Viti	Parashkollor	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Arsimi i lartë
2008	53	93	97	73
				30

- Identifikimi i aftësive të munguara sipas sektorëve, profesioneve dhe rajoneve

Shërbimi Kombëtar i Punësimit kryen studime periodike mbi tregun e punës dhe raportin mbi “Studimin e fuqisë punëtore nga këndvështrimi i ndërmarrjes”. Këto studime pasqyrojnë një vlerësim të nevojave për aftësi që paraqet tregu i punës për vitin 2009-2010, si dhe një parashikim të ndryshimeve të tyre për vitin 2011.

Realizimi i një vlerësimi të nevojave për aftësi dhe trajnimeve që organizojnë ndërmarrjet, ka një rëndësi të dorës së parë, duke qenë se evidentimi i tyre qëndron në thelb të shërbimeve, të tilla si këshillimi për punësim, orientimi në karrierë dhe formimi profesional. Ai i shërben,

¹⁴ Shiko tabelat shtesë në aneksin II – I.2.4 të këtij materiali.

¹⁵ Burimi i të dhënave, përveç Shqipërisë: UNESCO.

gjithashtu, njohjes së organizimit të punës, proceseve të arsimimit dhe formimit, si dhe ndikimit real të praktikave të zhvillimit të burimeve njerëzore.

Vlerësimi i aftësive të forcës së punës është fokusuar në mungesën e aftësive, pengesat për zhvillimin e kompetencave, arsyet e ndryshimit të aftësive etj. Një ndër arsyet e mospërputhjes së aftësive sipas analizës të sipërpërmendur është ndryshimi i teknologjive.

Këto ndryshime jepen si arsye kryesore nga 50% e ndërmarrjeve që parashikojnë ndryshime në teknologji.

Një element tjetër i rëndësishëm, i analizuar në studimin e sipërpërmendur është edhe mangësia e aftësive. Mangësitë e aftësive janë identifikuar kryesisht në industrinë përpunuese me 31%, tregti me 24% dhe në ndërtim me 23%.

Arsyet e mungesës së aftësive janë klasifikuar si më poshtë: 27% mungesa e përvojës së punës; 20% mungesa e trajnimit dhe zhvillimit të stafit; 14% problemet e rekrutimit; 12% paaftësi për të përballuar ndryshimin; 11% staf i pamotivuar etj.

Një burim tjetër informacioni mbi mungesën e aftësive apo mospërputhjen e tyre me nevojat e tregut identifikohet nga të dhënat administrative të marra nga zyrat e punësimit. Sipas këtyre të dhënave arsyet e mospërputhjes janë:

a) mospërputhja me nivelin e kualifikimit (32% e punëkërkueseve të regjistruar janë pa profesion);

b) Mospërputhja e profesioneve të punëkërkuësve të papunë të trashëguara nga e kaluara me profesionet e reja që kërkon tregu i punës sot;

c) Niveli i ulët arsimor i punëkërkuësve të papunë (53% janë me arsim deri në 9-vjeçar-*compulsory*), ndërkohë që tregu kërkon specialistë me nivel arsimor të paktën të mesëm.

C. ANALIZA E SITUATËS MIGRATORE NË VEND

C.1 Imigrantët

Në plotësimin e tabelave të këtij kapitulli janë përdorur 3 burime të dhënash: të dhëna nga Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin të Policisë Shtetit, nga Zyra Qendrore e Statistikave dhe të dhëna nga Drejtoria e Shtetësisë të Refugjatëve. Për një përkufizim më të qartë, duhet theksuar, që për sa u përket imigrantëve rezidentë në Shqipëri, bëhet fjalë për imigrantët që qëndrojnë të paktën mbi 3 muaj në Shqipëri dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, pra kanë qëndrim të rregullt në territor.

C.1.1 Numri i përgjithshëm i imigrantëve

Numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që qëndrojnë në Shqipëri për më shumë se një vit ka mbetur përafërsisht në 0,2–0,25% të popullsisë vendase gjatë kësaj dekade. Në Shqipëri, të dhënat e imigracionit paraqesin një strukturë të qëndrueshme të imigrantëve që vijnë nga vendet e rajonit. Në vitin 2010, shumicën dërrmuese (rreth 73%) të imigrantëve e përbënin ata me origjinë europiane, ndërsa 13% vinin nga Azia dhe 11% nga Amerika. Imigracioni nga vendet e tjera të botës ishte i papërfillshëm dhe kjo pjesë zinte vetëm 3%.

Prurjet migratore të shtetasve të vendeve të rajonit në kufi me Shqipërinë (Kosovë–Maqedoni–Mal i Zi–Serbi) kryesisht janë dominuar nga ata me etni shqiptare. Ndërmjet imigrantëve europianë në tërësi për vitin 2010: 47% (1649) ishin të shtetësisë turke; 20% (827) ishin italianë; 15% (601) ishin nga vendet kufitare (kryesisht Kosovë–Maqedoni); dhe afërsisht 18% erdhën nga vende të tjera të Europës. Pothuaj gjysma e imigrantëve aziatikë erdhën nga Kina (381 persona) dhe një pjesë e vogël nga Lindja e Mesme (103 persona). Imigrantët nga SHBA-ja përbënin 75% të emigrantëve amerikanë (463 persona), ndërsa imigrantët nga shtete afrikane zinin vetëm 3% (187 persona) të numrit total të imigrantëve (5663) për vitin 2010.



- Numri i përgjithshëm¹⁶

Të huajt imigrantë sipas grup-moshave dhe gjinisë

Viti	0-14	15-19	20-24	25-29	30-39	40-49	50-59	60-X	Total
Meshkuj									
2006	-	33	258	332	791	459	228	142	2243
2007	-	47	300	478	930	740	369	183	3047
2008	-	80	453	716	1506	1246	508	262	4771
2009	2	74	485	823	1735	1446	582	270	5417
2010	71	99	338	510	1147	905	468	296	3834
Femra									
2006	-	9	90	118	196	179	121	155	868
2007	-	25	104	155	266	179	135	175	1039
2008	-	11	100	163	245	202	148	172	1041
2009	1	18	151	233	366	244	164	201	1376
2010	75	48	207	317	463	308	195	216	1829
Total									
2006	-	42	348	450	987	328	349	297	3111
2007	-	72	404	633	1196	919	504	358	4086
2008	-	91	553	879	1751	1448	656	434	5812
2009	3	92	634	1056	2101	1690	746	471	6793
2010	146	147	545	827	1610	1213	663	512	5663

Të huajt imigrantë sipas shtetësisë së vendit të origjinës

Shteti	2006	2007	2008	2009	2010
Europa					
Austri	17	32	31	48	80
Bullgari	13	22	23	19	28
Finlandë	14	16	22	15	18
Francë	30	33	36	48	52
Gjermani	91	96	105	131	154
Greqi	89	117	131	145	171
Holandë	33	43	44	62	72
Itali	483	608	656	709	827
Kosovë	100	129	158	220	354
Kroaci	17	20	32	120	38
Maqedoni	73	74	143	142	154
Mbretëri e Bashkuar	77	83	102	115	119
Rumani	73	31	23	28	44

¹⁶ Këto të dhëna janë marrë nga baza e të dhënave në Sektorin e Migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin.
3478

Rusi	13	16	15	25	40
Spanjë	10	12	24	21	25
Turqi	477	1396	2573	2947	1649
Zvicër	24	36	36	39	41
Të tjera	115	130	144	173	248
Totali, Europa	1749	2894	4298	5007	4114
Azia					
Filipine	14	17	20	25	47
Indi	60	62	58	68	87
Iran	13	15	18	19	23
Jordani	22	13	11	11	16
Kinë	551	276	588	786	387
Kore	35	42	41	43	63
Pakistan	5	10	7	9	10
Siri	12	14	31	31	22
Tajlanda	3	4	5	5	4
Të tjera	36	45	41	50	74
Totali, Azia	751	498	820	1047	733
Amerika					
Argjentinë	6	7	13	14	19
Brazil	22	25	25	25	30
Kanada	20	17	28	50	59
Peru	8	15	7	10	9
SHBA	411	451	448	447	463
Të tjera	24	32	36	33	41
Totali, Amerika	491	547	557	579	621
Afrika					
Afrikë e Jugut	5	10	9	9	9
Egjipt	62	75	75	87	111
Kenia	5	7	7	8	12
Nigeri	8	13	15	16	15
Sudan	12	10	3	5	5
Të tjera	22	25	22	27	29
Totali, Afrika	114	140	131	152	181
Oqeania	6	7	6	8	8
Totali	3111	4086	5812	6793	5663

C.1.2 Lloji i imigrantëve

- Azilkërkues sipas shtetësisë¹⁷

Shtetësia	2008	Shtetësia	2009	Shtetësia	2010
Kosovë	4	Kosovë	4	Kosovë	3
-	-	Iran	1	Irak	4
-	-	Ujgur (Kinë)	1	Bosnje dhe Hercegovinë	1
-	-	-	-	Maqedoni	1
-	-	-	-	Iran	1
-	-	-	-	Arabi Saudite	1
-	-	-	-	Libi	1
-	-	-	-	Tunizi	1

¹⁷ Këto të dhëna janë marrë nga Drejtoria e Shtetësive në Ministrinë e Brendshme.



-	-	-	-	Egjipt	1
Totali	4	Total	6	Total	14

- Njohur statusi i refugjatit sipas shtetësisë

Shtetësia	2006	2007	2008	2009	2010
Algjeri	-	1	-	-	1
Egjipt	-	1	-	-	-
Indi	-	1	-	-	-
Irak	-	1	-	-	-
Iran	-	-	-	-	-
Kinë (Ujgur)	6	1	-	1	1
Kosovë	-	2	-	-	1
Libi	-	-	-	-	-
Tunizi	-	-	-	-	-
Uzbekistan	-	1	-	-	-
Totali	6	8	0	1	3

- Imigrantë të rregullt

Numri i përgjithshëm i lejeve të qëndrimit të lëshuara sipas kategorive kryesore

Motivi-kategoria	2006		2007		2008	
	Total	Sub/Tot	Total	Sub/Tot	Total	Sub/Tot
Bashkim familjar	288		494		555	
Bashkëshort		285		434		448
Fëmijë -18 vjeç		3		5		12
Anëtarë të tjerë		-		55		95
Studim	23		28		55	
Nxënës		3		5		24
Student		20		23		26
Punësim	1531		2177		3707	
I vetëpunësuar		139		147		159
I punësuar		1392		2030		3547
Kategori të tjera	1269		1387		1495	
Humanitare, fetare		1235		1355		1464
Përrjashtimore, azilkërkues		34		32		31
Arsye të tjera		-		-		-

Aplikimet për leje qëndrimi sipas motivit të qëndrimit

Motivi	2009	2010
Aktivitet fitimprurës (punësim, vetëpunësim)	4398	2601
Studim	90	183
Bashkim familjeje	622	977
Përrjashtimore, azilkërkues	35	42
Fetare-humanitare	1565	1547
Të tjera	83	313
Totali	6793	5663

C.1.3 Imigrantët e parregullt

Të dhëna vlerësuese për numrin e të huajve të kapur me qëndrim të parregullt në Shqipëri¹⁸

2007	2008	2009	2010
36	108	64	97

Pjesa më e madhe e shtetasve të huaj të kapur me qëndrim të paligjshëm në territor kanë hyrë ligjërisht dhe më pas kanë qëndruar ilegalisht, duke tejkaluar afatet kohore të përcaktuara në ligj. Motivi kryesor për qëndrim të paligjshëm në territor është motivi për qëllime punësimi të paligjshme. Statistikat e mësipërme për vitin 2010 i referohen identifikimit të personave të kapur në territor me qëndrim të paligjshëm.

Të dhënat për të huajt me qëndrim të parregullt për 5 shtetësitë kryesore

Shtetësia	2009	Shtetësia	2010
Afganistan	35	Turqi	32
Turqi	12	Egjiptian	18
Kinë	5	Palestinë	8
Kosovë	2	Kinë	7
Maqedoni	2	Afganistan	6

Tabloja e mësipërme tregon ndryshueshmërinë gjeografike të lëvizjes, referuar vendeve të origjinës në raport me vitet e krahasuara. Viti 2009 dominohet nga hyrjet dhe qëndrimet e paligjshme në territor të shtetësisë afgane që vijnë nga territori grek, ndërkohë që në 2010-ën është shtetësia turke që dominon me qëndrim të parregullt në territor.

Situata e parregullt e shtetasve turq në territor vjen si rezultat i shkeljeve të afateve të qëndrimit nga ana e tyre, pasi regjimi i lëvizjes midis Shqipërisë dhe Turqisë është pa viza me të drejtë qëndrimi 90 ditë për një periudhë kohore prej 180 ditësh. Në vitin 2010 vërehet një prurje e re shtetësie që është ajo palestineze dhe që transiton ilegalisht nga Greqia. Ky fakt është rezultat i situatës konfliktuale në rajonin e Lindjes së Mesme.

Shtetasit afganë, irakianë, iranianë dhe shtetasit të vendeve të treta nga Afrika kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet kufirit të gjelbër me Greqinë, si dhe në pikat e kalimit kufitar me Greqinë, të fshehur në kamionë, duke u përpjekur për të përdorur territorin e Republikës së Shqipërisë si një vend transit duke ndjekur itinerarin Greqi-Shqipëri-vendet e Ballkanit Perëndimor-vendet e BE-së.

Kryesisht këta shtetas nuk ndihmohen nga shtetas të tjerë në Greqi për të kryer udhëtimin e sipërpërmendur dhe në shumicën e rasteve ata përdorin harta të nxjerra nga interneti për të identifikuar rrugën që duhet të ndjekin.

Përveç rasteve të konstatuara në territor me shkelje të afateve të qëndrimit të të huajve, një konstatim tjetër i këtyre rasteve ka qenë në momentin e daljes së tyre nga Shqipëria nëpërmjet PKK-ve.

Të dhënat për të huajt e parregullt, të konstatuara gjatë daljes në kufi, në vitin 2010 sipas llojit të shkeljes dhe shtetësisë, si dhe të atyre të kapur duke kaluar kufirin në mënyrë ilegale.

¹⁸Të dhënat nga Zyra e Analizës së Riskut dhe Sektori i Ripranimeve në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin.



Shtetësia	Tejkalim i afatit të qëndrimit	Shtetësia	Hyrje e paligjshme
Turqi	146	Palestinë	9
Itali	47	Afganistan	6
Kinë	38	Somali	4
Poloni	17	Iran	1
Egjipt	3	Kolumbi	1
		Kamerun	1
		Turqi	1
Total	251	Total	23

Shtetasit e Maqedonisë, të Kosovës dhe të Turqisë, në bazë të regjimit të hyrjes në Republikën e Shqipërisë kanë hyrë pa vizë, ndërsa qytetarët e tjerë të listuar në tabelën e mësipërme, të cilët kanë hyrë legalisht, kanë hyrë me vizë dhe më pas kanë tejkaluar kushtet e qëndrimit.

Të huaj të ndaluar në përgatitje për largim (në qendrën e mbyllur) sipas shtetësisë

Shtetësia	2008	2009	2010
Afganistan	29	35	6
Egjipt	3	-	8
Brazil	3	-	1
Palestinë, Kamerun	-	2	9
Totali	40	37	36

Sipas legjislacionit shqiptar për të huaj, shtetasi i huaj i ndaluar (me vendim administrativ) nga Autoriteti Rajonal për Kufirin dhe Migracionin, akomodohet në qendrën e mbyllur për të huajt dhe përgatitet për largim nga territori brenda afateve ligjore që shkojnë deri në 18 muaj. Siç shihet në tabelën më lart, shtetasit e ndaluar në qendrën e mbyllur për të tria vitet që krahasohen, i përkasin vendeve të treta.

- Të huajt që u është refuzuar hyrja në kufi

Numri total i të huajve që u është refuzuar hyrja gjatë periudhës 2007-2010

Viti	2007	2008	2009	2010
Të huaj të refuzuar	522	407	417	503

Të huaj të refuzuar sipas shtetësive kryesore në vitet 2009-2010

Të huaj të refuzuar sipas shtetësive kryesore, viti 2009		Të huaj të refuzuar sipas shtetësive kryesore, viti 2010	
Serbi	62	Turqi	136
Bosnjë-Hercegovinë	48	Serbi	45
Maqedoni	36	Kosovë	41
Turqi	32	Maqedoni	25
Meksikë	24	Meksikë	17

Kosovë	24	Itali	15
Itali	15	Rusi	9
Greqi	15	Nigeri	8
Bullgari	7	Ukrainë	7
Totali	417	Totali	503

Gjatë vitit 2010 kemi një rritje me 20.6% të refuzimit të hyrjeve në Republikën e Shqipërisë. Kryesisht shtetasit e refuzuar janë me shtetësi turke 27%, serbe 8.9%, kosovare 8.1%, meksikane 3%.

Duke bërë një krahasim me vitin 2009 vërehet së gjatë vitit 2010 kemi një rritje shumë të madhe të refuzimeve të shtetasve turq në kufi, e cila arrin në 425%.

Përgjithësisht arsyet e refuzimit janë për:

- Mungesë të mjeteve financiare;
- Nuk disponojnë vizë të vlefshme për të hyrë në Republikën e Shqipërisë;
- Kanë përdorur dokumente të falsifikuara.
- Numri i të huajve të larguar

Numri i urdhrave të largimit, largim me forcë dhe dëbimeve lëshuar nga autoritetet rajonale për kufirin dhe migracionin

Shtetësia	2008	2009	2010
Afganistan	29	35	6
Kinë	36	5	7
Turqi	20	12	33
Të tjerat	13	12	51
Totali	108	64	97

Numri i të deportuarve (larguar me forcë)

Shtetësia	2008	2009	2010
Afganistan	29	35	6
Kinë	11	-	-
Egjipt	-	-	8
Të tjerat	-	1	12
Totali	40	36	36

- Numri i të huajve, viktimat të trafikimit të identifikuar

Gjatë periudhës 2008-2010, në kufirin e RSH-së nuk kemi identifikuar viktimat të mundshme të trafikimit në njerëz të shtetasve të vendeve të tjera. Në kufi, për të gjithë shtetasit që kthehen nga policitë e vendeve të tjera, bëhet intervistimi si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe të huaj, dhe zbatohen procedurat të posaçme të pritjes, intervistimit dhe më pas përzgjedhje, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Të gjitha intervistat hidhen *on-line* në një sistem të posaçëm elektronik bazë të dhënash, ku kanë akses një numër i zgjeruar institucionesh për të konsultuar ose plotësuar procedurën e intervistimit dhe të përzgjedhjes së viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit.



Numri i të huajve të kthyer vullnetarisht në vendin e origjinës sipas shtetësive kryesore gjatë viteve 2008-2010

Shtetësia	2008	2009	2010
Kinë	24	5	7
Turqi	20	12	33
Kosovë	8	2	2
Maqedoni	8	2	2
Greqi	3	2	2
Të tjera	5	7	15
Totali	68	28	61

Numri i të huajve të kthyer vullnetarisht të asistuar në vendin e origjinës sipas shtetësive kryesore gjatë viteve 2008-2010

Shtetësia	2008	Shtetësia	2009	Shtetësia	2010
Egjipt	2	Nepal	1	Kamerun	1
Marok	1	Turqi	1		
Totali	3		2		1

Në kuadrin e Programit të Kthimit Vullnetar të Asistuar (KVA) të IOM Tirana, Autoriteti për Kufirin dhe Migracionin ka bashkëpunuar për mundësimin e largimit vullnetar të shtetasve të vendeve të treta në vendet e tyre të origjinës, përkatësisht në të tria vitet e krahasuara në tabelën me lart.

- Vlerësimi i numrit të të huajve që punojnë ilegalisht

Gjatë vitit 2010, nga inspektimet e 14.642 subjekteve të inspektuara në shkallë vendi, janë evidentuar 1254 punëmarrës të huaj. Nga punëmarrësit e huaj të evidentuar, rezulton së 210 prej tyre kanë rezultuar pa leje pune.

- Rrugët joligjore të imigracionit të parregullt, përfshi kontrabandimin

Pozita gjeografike e Ballkanit, vendosur në kryqëzim të rrugëve, të cilat kanë si drejtim përfundimtar Europën Qendrore, e kthejnë këtë zonë dhe shtetet përbërëse të tij në një hapësirë e cila mund të shfrytëzohet si zonë transit për në destinacionin final të shtetasve të vendeve të treta, të cilët lëvizin në mënyrë të parregullt.

Përgjithësisht gjatë vitit 2010, mbështetur edhe në statistikat e sipërpërmendura, rezulton se nëpërmjet territorit të Shqipërisë kanë tentuar të kalojnë transit shtetas nga Lindja e Mesme, kryesisht afganë dhe irakianë, ndërkohë që po evidentohen edhe tentativa të shtetasve palestinezë gjatë fundit të këtij viti.

Rrugët kryesore të cilat përdorin shtetasit e vendeve të treta janë:

- Për shtetasit afganë: Afganistan–Iran–Turqi–Greqi–Shqipëri.

- Për shtetasit palestinezë: nëpërmjet vendeve të Afrikës së Veriut–Turqi–Greqi–Shqipëri.

Imigrantët e parregullt, përgjithësisht nga Afganistani, Iraku dhe Palestina, hyjnë në Turqi, më pas kalojnë në Greqi dhe nëpërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor synojnë vendet e BE-së dhe kryesisht ato nordike.

Pasi lëvizin në mënyrë të organizuar nga persona të tjerë, në territoret e shteteve, si: Irani dhe Turqia, këta shtetas më pas kalojnë në Greqi, duke u punësuar për periudha të shkurtra kohore në mënyrë që të sigurojnë të ardhura për vazhdimin e mëtejshëm të udhëtimit.

Deri tani rezulton së shtetasit e etnive të sipërpërmendura lëvizin duke u mbështetur në informacione dhe udhëzime të marra nga bashkëkombës të tyre, të cilët jetojnë në Greqi ose nëpërmjet informacioneve të marra nga interneti.

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ka rezultuar të hyjnë kryesisht në orët e para të mëngjesit ose në të errur, në vende jo shumë larg pikave të kalimit kufitar, për të mos humbur orientimin me rrugët automobilistike, si dhe në grupe të vogla, 3-5 vetë.

Megjithatë, janë identifikuar disa raste të këtyre shtetasve të fshehur në kamionë, ku hyrja dhe fshehja është realizuar natën në territorin grek, gjatë momenteve kur këto mjete kanë qenë në parking.


Territori i Shqipërisë është tentuar të përshkohet me mjete të transportit publik, kryesisht autobusë.

Kanë preferuar të përdorin territorin e Shqipërisë më shumë ata shtetas që janë gjendur në pjesën e Janinës dhe Igumenicës në Greqi, përkundrajt atyre në pjesën e Selanikut të Greqisë, kjo për shkak të distancës së shkurtër për të përshkruar territorin shqiptar.

Drejtimi i mëtejshëm i lëvizjes së tyre ka qenë Shqipëri-Mali i Zi-Kroaci dhe më pas vendet e BE-së.

Me qëllim vështirësimin e procedurave të kthimit në Greqi, këta shtetas kanë preferuar të udhëtojnë pa dokumente udhëtimi, si dhe duke fshehur çdo provë që provonte vendin nga kishin hyrë në Shqipëri.

Nuk kanë preferuar të kërkojnë azil apo të qëndrojnë në Shqipëri në momentin kur janë ndalur nga shërbimet e kufirit dhe migracionit, por kanë deklaruar se duan të vazhdojnë rrugën drejt vendeve të BE-së.



C.2 Emigrantët

C.2.1 Numri i përgjithshëm i emigrantëve

- Numri i përgjithshëm

Numri i përgjithshëm i emigrantëve i referohet stokut të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit.

Flukset migratore 2007-2010 i referohen numrit të shtetasve shqiptarë që kanë emigruar në vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2010. Lidhur me sistemin e regjistrimit të shtetasve shqiptarë, të cilët emigrojnë në Shqipëri, mund të themi së janë tri ministri të cilat kanë kompetenca lidhur me regjistrimin.



Në ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” (të ndryshuar), parashikohet regjistrimi i shtetasve shqiptarë që duan të emigrojnë për motive punësimi nga strukturat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Megjithatë, duke qenë se regjistrimi i shtetasve shqiptarë në këtë regjistër nuk është i detyrueshëm por është mbi baza vullnetare dhe i bazuar në iniciativa lehtësuese të procesit të emigrimit, nga këto struktura, numri i shtetasve shqiptarë që emigrojnë të regjistruar në strukturat e MPÇSSHB-së është shumë i vogël dhe jo përfaqësues i fluksit migrator shqiptar në vite.

Gjithashtu, duke qenë se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur emigracion të organizuar nga strukturat shtetërore, mungojnë të dhënat në këtë drejtim nga MPÇSSHB-ja.

Në ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” (të ndryshuar), parashikohet gjithashtu regjistrimi i shtetasve shqiptarë nga Ministria e Brendshme. Ministria e Brendshme, në zbatim të këtij ligji, monitoron sistemin e regjistrimit dhe të kontrollit kufitar për emigrantët shqiptarë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shkëmben informacion për numrin, shtetet dhe kohëzgjatjen e qëndrimit të emigrantëve shqiptarë. Megjithëse nga ana e strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit bëhet regjistrimi në kufi i të gjithë shtetasve që hyjnë dhe dalin nëpërmjet PKK-ve, kjo dhe në bazë të qëllimit të lëvizjes, në kushtet kur shtetasit shqiptarë lëvizin disa herë brenda një viti apo tani që mund të përdorin dhe pasaportën biometrike si dokument të vetëm udhëtimi, është e vështirë që nga këto struktura të përfitohet një shifër e saktë mbi emigrantët jashtë vendit.

MPJ-ja, nëpërmjet bashkëpunimit me komunitetet emigratore shqiptare jashtë vendit, mund të sigurojë një informacion të tillë.

Përfitimi i të dhënave nga vendet e destinacionit mbi numrin emigrantëve shqiptarë në këto vende do të ishte mënyra më e mirë dhe e saktë e menaxhimit të flukseve emigratore. Publikimi i profileve të migracionit nga këto vende do të ishte një nga mënyrat e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin në mes vendeve.

Ky profil i zgjeruar i migracionit të Shqipërisë nga të dhënat e publikuara mbi imigracionin legal në Shqipëri, ofron të dhëna statistikore mbi emigracionin për të gjitha vendet, shtetasit e të cilave janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

C.2.2 Lloji i emigrantëve

Arsyeja themelore e emigracionit është ekonomike. Emigracioni masiv i pakontrolluar buroi nga kushtet e vështira ekonomike ndërthurur me ato politike, pasojë e regjimit komunist. Më pas emigracioni shqiptar është në masën e vet mbizotërues i karakterit ekonomik.

Një tjetër shkak janë edhe faktorët e sigurisë dhe të qetësisë, të cilët në momente të veçanta (p.sh. në vitin 1997) kanë ndikuar posaçërisht në zgjedhjen e rrugës së emigrimit.

Shkollimi i fëmijëve dhe përgjithësisht siguri i një të ardhmeje më të mirë e më të sigurt për ta përbën një tjetër motiv që haset shpesh në vendimin që marrin familjet për të emigruar.

Të gjitha këto përfshihen në konceptin për një jetë më të mirë, me të cilin përlligjet rëndom shtyja për të emigruar. Ky koncept, në raport me faktorët, të tillë si: papunësia, të ardhurat e pamjaftueshme për jetesë, problemet e strehimit etj., është i pamatshëm dhe përmban elemente subjektive të perceptimit, shpresave, standardeve dhe aspiratave të individëve të veçantë. Pikërisht me këto perceptime individuale dhe subjektive shpjegohet fakti që zgjedhjen e emigracionit e kanë bërë jo vetëm individë apo familje me të ardhura shumë të vogla apo të vogla, por edhe ata që kanë të ardhura të mjaftueshme për një jetesë normale, madje, ndonjëherë, mjaft të mirë në Shqipëri; po kështu individë me arsim të lartë kanë parapëlqyer të emigrojnë edhe kur në vendin pritës kryejnë punë inferiore në krahasim me profesionin dhe punën që kanë pasur në Shqipëri.

Për sa i përket përbërjes demografike, shoqërore dhe kulturore të emigrantëve shqiptarë, mund të thuhet se:

- Në emigracionin shqiptar mbizotërojnë moshat e reja (deri në 30 vjeç) dhe mesatare (40-50 vjeç). Duke pasur parasysh se flukset migratore gjatë viteve të fundit janë ulur, prirja e përgjithshme e emigracionit shqiptar do të jetë rritja e moshës mesatare.

- Në mënyrë deduktive mund të pohohet që meshkujt përbëjnë pjesën më të madhe të emigracionit.

- Prejardhja gjeografike e emigrantëve përfshin të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe është e vështirë të përcaktohet nëse ata me prejardhje nga fshati mbizotërojnë mbi elementët me prejardhje qytetare.

- Ndërsa mund të pohohet se niveli arsimor i shumicës së emigrantëve ka qenë i ulët. Vitet e fundit emigracioni është “ushqyer” me një kontingjent me shkallë më të lartë arsimimi dhe kulture, qoftë për shkak të prurjeve migratore, qoftë për shkak se një pjesë e mirë e studentëve shqiptarë, që kanë përfunduar studimet jashtë vendit kanë zgjedhur të qëndrojnë në vendin pritës.

- Ndonëse nuk ka të dhëna sistematike dhe të besueshme për punësimin, profesionet që ushtrojnë, statusin ekonomik etj. të emigrantëve shqiptarë, informacioni i disponueshëm dhe vëzhgimet sporadike shtojnë të mendohet se shumica dërrmuese e emigrantëve shqiptarë ushtrojnë profesione që i përkasin punës fizike dhe numri i intelektualëve që ushtrojnë profesionet e tyre është i paktë. Në veçanti, gratë, edhe me arsim të lartë, punojnë në një shkallë të madhe në shtëpitë e vendasve (si: pastruese, bebisiter etj.).

C.2.3 Emigrantët e parregullt

Emigracioni i paligjshëm dhe për vitin 2010 është zhvilluar kryesisht drejt Greqisë (98%) dhe më pas drejt vendeve të tjera të BE-së, si: Itali, Gjermani, Francë, Belgjikë, Angli etj.

Numrin e emigrantëve të paligjshëm e përbëjnë shtetas shqiptarë të kthyer nga vendet e destinacionit apo të transitimit, si dhe ato të kapur në tentativa për kalim të paligjshëm për kalim kufiri.

Në raport me vitin 2009, në vitin 2010 vihet re një ulje me 12 567 raste të emigrimit të paligjshëm. Në total për vitin 2010 janë regjistruar 53 711 raste kthimi të shtetasve shqiptarë dhe 3 raste kthimi të shtetasve të vendeve të treta. Kjo ulje erdhi si rezultat i masave të marra për forcimin e kontrollit të kufirit në kuadër të angazhimit për të plotësuar detyrimet për përfitimin e procesit të liberalizimit të regjimit të vizave me BE-në për shtetasit shqiptarë, si dhe nga fushata informuese për qytetarët mbi këtë proces që filloi nga mesi i vitit 2010.

Tabela e kthimeve sipas grup-moshave dhe gjinisë për vitin 2010¹⁹

Totali	Meshkuj	Femra	Meshkuj nën 18 vjeç	Femra nën 18 vjeç
53 711	51733	1978	7968	367

Tabela e kthimeve sipas listës së shteteve kryesore për vitet 2009, 2010

Vendet në krye të listës	Viti 2009	Viti 2010
1 Greece/Greqi	62639	50735
2 Italy/Itali	1444	1150
3 United Kingdom/Mbretëria e Bashkuar	524	340
4 Germany/Gjermani	223	185
5 France/Francë	222	153
6 Belgium/Belgjikë	152	84
7 Switzerland/Zvicër	347	229

¹⁹ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.4 të këtij materiali.



Nga strukturat e shërbimeve të Policisë Kufitare dhe Migracionit, gjatë vitit 2010 janë kapur në tentativë për të kaluar kufirin nga Shqipëria drejt vendeve të tjera 18 338 shtetas shqiptarë ose 675 raste më shumë se në vitin 2009. Janë identifikuar dhe ndjekur penalisht në 96 raste për dhënie ndihme për kalim kufiri ose 47 raste më shumë se në vitin 2009.

C.3 Diaspora jashtë vendit

Diaspora shqiptare paraqitet më shumë veçori krahasuar me vendet e tjera. Në raport me popullsinë shqiptare që jeton në trojet etnike, gjykohet të jetë ndër më të mëdhatë në botë. Shkaqet e krijimit përfshijnë zhvillimet historike, politike, ekonomike, sociale etj. Diaspora shqiptare numëron miliona vetë të shpërndarë në të gjitha kontinentet. Kryesisht është e vendosur në: Turqi, SHBA, Greqi, Itali, Gjermani, Zvicër, Suedi, Britaninë e Madhe, Kanada, Australi, Argjentinë, por edhe në rajon, si në Rumani e Bullgari, Ukrainë etj.

Dukuria e emigrimit të shqiptarëve jashtë vendit nuk është e re. Ajo është e dokumentuar të paktën që në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë me largimin e një mase të madhe banorësh të trevave shqiptare, veçanërisht nga jugu i vendit, pas pushtimit të Gadishullit Ballkanik nga Perandoria Osmane. Rezultat i këtyre valëve migratore ishte krijimi i ngulimeve të rëndësishme shqiptare në Italinë e Jugut, Greqi, në bregdetin e Dalmacisë e gjetkë. Modeli më i spikatur është komuniteti arbëresh i vendosur në Sicili e Kalabri. Gjatë shekujve që pasuan, deri në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, në vitin 1912, proceset migratore vazhduan në formën e lëvizjeve “të brendshme” nga trevat shqiptare në rajone të tjera të Perandorisë Osmane ose në vende fqinje, të cilat me kalimin e kohës, fituan autonomi apo pavarësi nga Porta e Lartë. Këtyre lëvizjeve u detyrohet krijimi dhe konsolidimi i komuniteteve relativisht të rëndësishme shqiptare në rajonet e Turqisë së sotme, në Egjipt, Siri, Bullgari, Rumani e në ndonjë vend tjetër.

Periodha që nis me fillimin e shekullit XX dhe, në veçanti, me formimin e shtetit shqiptar solli një ndryshim të rrugëve të emigrimit. Emigrimi drejt Turqisë vazhdoi përsëri, kryesisht për hir të lidhjeve që ekzistonin me ata që qenë vendosur atje, por tani ky vend, me problemet e shumëllojta që solli rënia e Perandorisë, nuk përbënte më një truall të parapëlqyer për emigrim. Prandaj shqiptarët u orientuan kryesisht drejt SHBA-së, Argjentinës, Australisë dhe në një numër më të kufizuar edhe në ndonjë vend europian (Francë, Austri, Itali). Një kontingjent të veçantë përbënte emigracioni politik i larguar nga Shqipëria si rezultat i qëndrimit dhe veprimtarisë kundërshtuese ndaj Monarkisë së Mbretit Zog dhe pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri.

Harta e shpërndarjes së diasporës shqiptare është mjaft e gjerë. Ajo përfshin thuajse të gjitha shtetet e Europës Perëndimore, disa vende të Europës Lindore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadanë. Por, në të vërtetë, ka edhe shumë vende të tjera ku është shtrirë emigracioni shqiptar, ndonëse në përmasa më të vogla. Në mungesë të një regjistrimi të saktë zyrtar të shtetasve shqiptarë të vendosur jashtë territorit të shtetit shqiptar, të dhënat që do të pasqyrohen më poshtë duhen marrë si të përafërta. Burimi i tyre janë përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore jashtë shtetit ose janë nxjerrë pjesërisht nga burime zyrtare lokale (në disa vende dhe kur është fjala për emigrantë të legalizuar) dhe pjesërisht nga shoqatat e shqiptarëve, organizatat joqeveritare etj. Sipas këtyre burimeve, rezulton se aktualisht jetojnë dhe punojnë jashtë vendit rreth 1 milion e 400 mijë shtetas shqiptarë. Pjesa më e madhe, mbi 70% e këtij numri, është vendosur në dy vende: Greqi dhe Itali, dhe midis tyre Greqia zë vendin e parë. Parapëlqimi i shqiptarëve për këto dy vende dhe sidomos për Greqinë u kushtëzua prej faktorit gjeografik. Drejtimi i valës së parë të lëvizjes migratore ishte kufiri tokësor i Greqisë në vitin 1991. Kjo tendencë vazhdoi për disa vite me radhë, sidomos nga zonat jugore të Shqipërisë. Lëvizja e shqiptarëve drejt fqinjit jugor u favorizua edhe nga aftësitë e tregut grek të punës për të thithur krahun shqiptar të punës.

Italia ishte destinacioni i dytë. Mundësitë e kalimit drejt Italisë nuk ishin të njëjta dhe rreziqet e shpenzimet për emigrimin e paligjshëm ishin më të mëdha. Përgjithësisht, prirja e emigrantëve shqiptarë me kalimin e viteve është orientuar drejt vendeve më të zhvilluara të Europës Perëndimore (Itali, Gjermani, Belgjikë, vendet e Skandinavisë, Britani e Madhe etj.), si dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë. Këtu vërehet më qartë edhe dukuria e rritjes së përbërjes “intelektuale” të emigracionit shqiptar.

C.4 Dërgesat e këmbesave që jetojnë jashtë (Remitanca)

Dërgesat e emigrantëve kanë qenë një ndër burimet kryesore të ekonomisë shqiptare pas viteve 1991. Referuar profilit të migracionit të vitit 2007, rezulton se dërgesat e emigrantëve për këtë periudhë kohe ishin 3 herë më të larta sesa investimet e huaja direkt në fushën e ekonomisë në Shqipëri, si dhe dy herë më të larta se ndihma zyrtare që i është dhënë Shqipërisë për zhvillim²⁰. Gjithashtu, kontributi i dërgesave të emigrantëve, sipas Strategjisë Kombëtare mbi Migracionin 2005-2010, për një periudhë 10-vjeçare është vlerësuar rreth 15% e produktit të brendshëm bruto²¹.

Tabela e kursit mesatar të këmbimit valutor dhe bilancit të pagesave²²

Kursi i këmbimit, mesatare vjetore	2005	2006	2007	2008	2009	2010
ALL/EUR	124.18	123.09	123.63	122.81	132.08	137.79
ALL/USD	99.88	98.13	90.43	83.90	94.98	103.93
Bilanci i pagesave (milion euro)	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Remitancat	802.2	937.2	951.9	833.5	781.4	689.8
Hyrjet	802.2	937.2	951.9	833.5	782.3	696.5
Daljet	0	0	0	0	-1.1	-6.8

D. ANALIZA E FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË MIGRACIONIN NË VEND

D.1 Karakteristikat kryesore të tregut aktual të imigracionit

Duke filluar nga fillimi i viteve '90, vala e flukseve imigratore në Shqipëri ka qenë në rritje. Numrin më të madh, imigrantët në Shqipëri e shënojnë në vitin 2008-2009, ku një ndikim kishte ndërtimi i rrugës Durrës-Kukës, ku kërkoheshin punëtorë të kualifikuar, si dhe ndërtuese e kësaj rruge ishte një kompani turko-amerikane. Tregun e imigracionit e kanë furnizuar, gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i shtetasve të vendeve fqinje, kryesisht pjesa me popullatë shqiptolëse.

Nisur nga aktiviteti i madh i shumë shoqatave të huaja, kryesisht atyre fetare dhe humanitare në Shqipëri dhe veçanërisht në vitet 1991-2005, stoku imigrator ka përfshirë një numër të konsiderueshëm të të huajve rezidentë në Shqipëri, në raport me numrin e përgjithshëm të të huajve rezidentë, pikërisht për këto motive.

Sipas të dhënave të tregut, përqindja e imigrantëve nuk është e lartë. Ajo përbën 0.2-0.25% të popullsisë shqiptare.

Vendi kryesor i origjinës së imigrantëve është Turqia, kjo për shkak të lehtësimit të regjimit të vizave, heqjes së tyre që në vitin 1992. Në këtë mënyrë shtetasit turq kishin mundësinë të vizitonin Shqipërinë dhe të gjenin mundësi punësimi dhe jetese. Imigracioni në rritje ka qenë kryesisht nga vendet e Europës, ku shumica e imigrantëve ka ardhur nga Italia dhe Greqia, por një numër i konsiderueshëm i imigrantëve ka ardhur nga Kina dhe SHBA-ja.

²⁰ Profili i migracionit të vitit 2007, f. 15. dhe f. 30.

²¹ Strategjia Kombëtare për Migracionin, f. 11.

²² Bilanci i Pagesave sipas Bankës së Shqipërisë.



Imigrantët në Shqipëri janë të përqendruar në kryeqytet (Tiranë 67%) dhe në qytetet që shtrihen gjatë bregut perëndimor: Durrës (15%), Shkodër (8%), Vlorë (5%).

Numri i imigrantëve të shpërndarë sipas DRKM-së

Drejtoria rajonale	2007	2008	2009	2010
DRKM Tiranë	3019	4064	4728	3819
DRKM Durrës	435	794	1105	836
DRKM Shkodër	262	309	365	463
DRKM Vlorë	176	367	343	302
Të tjera	194	278		
Totali	4086	5812	6493	5663

Në vazhdimësi, Shqipëria është vend transiti në përballjen me flukset imigratore ilegale. Për vetë pozitën gjeografike të Shqipërisë, si pjesë përbërëse e Europës Juglindore dhe me kufij tokësorë e detarë me: Italinë, Greqinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë, mbetet rrezik rritja e flukseve migratore të parregullta, e cila kërkon rritjen e aktiviteteve në menaxhimin e kufijve dhe përmirësimin e koordinimit të punës ndërmjet strukturave përgjegjëse.

D.2 Faktorët nxitës të migracionit

Ashtu siç migracioni është një fenomen kompleks, shumëdimensional, në të cilin ndërthuren aspekte sociale, ekonomike, shoqërore, kulturore, politike, juridike etj. etj., faktorët nxitës të migracionit ekzistojnë pikërisht në kompleksitetin e këtyre fushave.

Faktorët nxitës të migracionit përbëhen, si nga faktorët shtytës në vendin e origjinës, ashtu dhe nga faktorët tërheqës në vendin e destinacionit.

- Emigracioni ilegal

Faktorët shtytës

- Disniveli ekonomik i vendi tonë me vendet e zhvilluara të BE-së, dy prej të cilave Italia e Greqia, që janë vende fqinje, por edhe izolimi i Shqipërisë për gati gjysmë shekulli ishin faktorët kryesorë që e bënë Shqipërinë si vend që jo vetëm dëshiron të migrojë, por në vitet 1991 emigrimi ishte nevojë mbijetese.

- Papunësia dhe pagat e ulëta, që ofron biznesi privat në Shqipëri, është një faktor tjetër i rëndësishëm i mjedisit që favorizon tendencat emigratore.

- Situata e përgjithshme jo e qëndrueshme në vend, si dhe trazirat kryesisht të viteve 1997 dhe 1998 kanë qenë faktorë të rëndësishëm shtytës dhe që nxitën një numër të madh emigrantësh shqiptarë drejt vendeve të BE-së.

- Konfliktet individuale shpeshherë kanë shërbyer si arsye për të zgjedhur emigrimin si “zgjidhje”.

Gjatë vitit 2010, ndër faktorët shtytës mund të përmenden: papunësia, pagat e ulëta, që ofron biznesi privat në Shqipëri, tendenca për një mundësi më të mirë se në Shqipëri, si dhe pamundësia për të lëvizur pa viza apo vështirësitë për të marrë vizë të nevojshme për të lëvizur, kryesisht drejt vendeve të BE-së.

Faktorët tërheqës

- Ekziston mbështetja prej më shumë se një milion shqiptarë, që jetojnë e punojnë në vendet e BE-së dhe më së shumti në Greqi e Itali për një migracion të vazhdueshëm.

- Niveli i lartë i ekonomisë informale në Greqi ka bërë të mundur punësimin në aktivitetet private të shtetasve shqiptarë, të cilët kanë hyrë dhe kanë qëndruar në mënyrë ilegale në Greqi.

- Një faktor tjetër lidhet me lehtësinë që imigrantët ilegalë kanë pasur për të kaluar kufirin tokësor, si pasojë e terrenit dhe kostove të ulëta të transferimit nga Shqipëria në Greqi.

- Lidhjet ekzistuese familjare të shtetasve shqiptarë me emigrantët në vendet e BE-së, ndërkohë që ky numër është relativisht i lartë. Çdo familje shqiptare ka një ose më shumë lidhje familjare me emigrantë në vendet e BE-së.

- Legalizimet e herëpashershme të emigrantëve të paligjshëm në vendet e BE-së kanë nxitur shtetasit shqiptarë për të hyrë në mënyrë të paligjshme në këto vende me qëllim përfitimin nga këto legalizime.

- Imigracioni ilegal

Faktorët shtytës

- Situata jo e qëndrueshme politike në vendet e Lindjes së Mesme dhe nga Afrika ka sjellë si efekt zvogëlimin e aftësive të policisë për ruajtjen e rendit publik në këto vende, e cila është pasuar me rritjen e veprimtarisë së grupeve kriminale. Grupet e krimit të organizuar, duke shfrytëzuar edhe mundësitë e udhëtimit, po lehtësojnë transferimin e mijëra emigrantëve të paligjshëm nga kjo zonë në drejtim të Europës Juglindore dhe më pas në atë të Europës Qendrore.

- Numri i madh dhe në rritje i emigrantëve të paligjshëm nga vende dhe rajone, në të cilat grupet terroriste islamiste janë aktive, të tilla si: Afganistani, Iraku, Pakistani dhe Somalia.

- Pranimin e mundshëm të Rumanisë dhe Bullgarisë në zonën *Schengen*.

Faktorët tërheqës

- Pozita gjeografike e Shqipërisë, pjesë përbërëse e Europës Juglindore dhe me kufij tokësorë e detarë me Italinë, Greqinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë, mund të shihet nga emigrantët e paligjshëm, si një vend transit për në vendet e Bashkimit Europian të Europës Qendrore.

- Legjislacioni shqiptar u jep mundësinë qytetarëve të disa vendeve që kanë nevojë për vizë për të hyrë në zonën *Schengen*, të hyjnë në Shqipëri pa vizë. Kjo mund të krijojë në të ardhmen mundësinë për këta shtetas për ta përdorur Shqipërinë si vend transit.

Konstatohet një rritje e cilësisë së dokumenteve të udhëtimit të falsifikuara të prodhuara me ndihmën e specialistëve të kualifikuar, të cilat mund të përdoren nga shtetas të vendeve të treta për të kaluar transit në Shqipëri.

D.3 Tregu i mundshëm i migracionit në të ardhmen

Për arsye të faktorëve demografikë, migracioni mendohet të jetë në rritje, për shkak të plakjes së popullsisë së vendeve të zhvilluara dhe rritjes së saj në vendet në zhvillim.

Megjithatë, pozicioni i Shqipërisë në fluksin e migracionit është i ndikuar nga pozicioni i saj, i cili shërben si rrugë kalimi i emigrantëve nga Jugu i Ballkanit për në vendet e BE-së.

Shqipëria së fundmi po lakmohet si vend destinacioni i emigracionit të ligjshëm, kryesisht për motive punësimi dhe studimi, por faktorët tërheqës për një gjë të tillë mund të shërbejnë dhe si të tillë për emigracionin e paligjshëm.

Nga ana tjetër, me kalimin e viteve numri i emigrantëve shqiptarë në vendet e Europës Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ketë prirjen të ulet, sepse një numër gjithnjë e më i madh i tyre do të përfitojë nga procedurat e marrjes së shtetësisë vendase.

Gjithsesi, duket se ka një prirje për një integrim më cilësor në jetën ekonomike. Po kështu, ekziston një numër emigrantësh, të cilët tashmë kanë krijuar bizneset e tyre vetjake.

E. MODULE SPECIFIKE TË VENDIT ME ÇËSHTJE ME INTERES TË VEÇANTË

Shqipëria ka një sistem të përfaruar të vizave me BE-në. Për të hyrë dhe transituar në Republikën e Shqipërisë, të huajve që u kërkohet vizë, u duhet të pajisen me vizë të tipit “B”.

Të huajt që kërkojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë për qëllime afatshkurtra duhet të pajisen me vizë të tipit “C”.



Të huajt që kërkojnë të hyjnë me vizë për qëllime afatgjata, duhet të pajisen me vizë të tipit “D” dhe më pas, pasi kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë, brenda 60 ditëve nga hyrja duhet të aplikojnë për leje qëndrimi pranë zyrave të migracionit në nivel rajonal të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Të huajt që hyjnë në Republikën e Shqipërisë për motive punësimi duhet më parë të pajisen me leje pune apo përjashtim nga leja e punës.

Lejet e qëndrimit jepen me afat 3 muaj, 6 muaj dhe 1 vit për herë të parë. Ato mund të përsëriten dy herë radhazi për periudha 2-vjeçare. Pas periudhës 5-vjeçare, pa ndërprerje të lejes së qëndrimit, i huaji mund të pajiset me leje qëndrimi të përhershme.

Shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë mund të aplikojnë për leje qëndrimi brenda 60 ditëve nga hyrja e parë e tyre. Bëjnë përjashtim shtetasit turq, për të cilët, nëse duan të qëndrojnë më shumë se 90 ditë duhet të pajisen me vizë të tipit “D”.

Çdo i huaj nuk mund të qëndrojë më shumë se 90 ditë për 180 ditë në Republikën e Shqipërisë. Për të qëndruar më shumë ai ose ajo duhet të pajisen me leje qëndrimi.

Vizat dhe lejet e qëndrimit për arsye humanitare dhe fetare lëshohen gratis.

Leja e qëndrimit të përhershëm është një tip i veçantë leje, që lëshohet për shtetasit e huaj që kanë pesë vite qëndrimi të rregullt pa ndërprerje.

Shtetasi i huaj mund të aplikojë për shtetësinë shqiptare pasi të ketë qëndruar së paku 5 vite pa ndërprerje me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri. Janë të favorizuar aplikantët që kanë kombësi shqiptare dhe kanë pasur prindërit me shtetësi shqiptare, të cilët mund të aplikojnë pas 3 vitesh qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në rastet e bashkimit martesor me një shtetas/shtetase shqiptar/e, i huaji mund të aplikojë për marrjen e shtetësisë shqiptare pas një viti qëndrimi të ligjshëm. Gjithashtu, favorizohen në këtë drejtim shtetas të huaj për interesa të veçantë në fushën e shkencës, kulturës, sportit, edukimit. Fëmijët e lindur në Shqipëri nga prindër të huaj, marrin automatikisht shtetësinë shqiptare, nëse gjatë regjistrimit kjo kërkohet nga prindërit.

F. POLITIKAT DHE PROGRAMET MIGRATORE DHE EFEKTIVITETI I TYRE NË MENAXHIMIN E MIGRACIONIT DHE SFIDAVE TË ZHVILLIMIT

F.1 Përshkrim i kuadrit institucional kombëtar dhe politika për migracionin

Politika migratore e Republikës e Shqipërisë përbëhet nga politikat imigratore dhe politikat emigratore, të shprehura këto në normativën migratore të hartuar dhe miratuar për këtë qëllim, në përputhje me politikën migratore dhe normativën migratore të BE-së, duke synuar minimizimin e kostove nga migracioni i paligjshëm dhe maksimizimin e përfitimeve nga migracioni i ligjshëm, si për migrantët ashtu dhe për vendet, nëpërmjet menaxhimit të flukseve migratore, duke garantuar liritë dhe të drejtat themelore të migrantëve nga njëra anë dhe luftë kundër migracionit të paligjshëm nga ana tjetër, si dhe përmes parandalimit të migracionit të parregullt, nxitjes së kthimit vullnetar dhe promovimit të lidhjes migracion-zhvillim i vendit.

Politika migratore në vetvete përbëhet nga politika e dokumenteve të udhëtimit, politika e vizave, politika e punësimit, politika e qëndrimit, politika e ribashkimit familjar, politika e të miturve të pashoqëruar, politika e luftës kundër migracionit të paligjshëm, përfshirë këtu hyrjen e paligjshme, qëndrimin e paligjshëm, punësimin e paligjshëm, martesat me qëllim dokumentacioni, përgjegjësitë e transportuesit, politika e kthimit, ripranimeve dhe riintegritimit të qëndrueshëm të të kthyerve, politika e largimeve dhe dëbimeve, politika e ndalimit, politika e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve dhe mbrojtjes së të dhënave personale, politika e masave represive dhe ankimit, politika e integritimit të emigrantëve etj.

Politika migratore shqiptare është e shprehur në Kushtetutë, si kornizë garantuese e të drejtave dhe lirive të të huajve, e rregulluar me anë të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore të dala posaçërisht, si dhe urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse.

F.1.1 Legjislacion shqiptar mbi migracionin

Legjislacioni shqiptar mbi migracionin përbëhet nga legjislacioni i brendshëm mbi migracionin, si dhe i gjithë kuadri i akteve dy- apo shumëpalëshe të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Legjislacioni i brendshëm mbi migracionin:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nr. 84, datë 21.10.1998, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, datë 7.12.1998, faqe 1073, e cila në mënyrë direkte, në pikën 1 neni 16 kreu I pjesa e dytë; neni 19 kreu I pjesa e dytë; germa “dh” pika 2 neni 27 kreu I pjesa e dytë; neni 38 kreu I pjesa e dytë neni 39; kreu I pjesa e dytë neni 40; kreu I pjesa e dytë; si dhe nëpërmjet klauzolave “kushdo” që gjenden në përmbajtjen e saj, garanton çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e të huajve në Republikën e Shqipërisë, si: liria e lëvizjes, mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë dhe me dinjitet të të huajve, mbrojtjen e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, ndalimin e dëbimeve kolektive të shtetasve të huaj, të drejtën e proceseve të ankimeve gjyqësore etj., duke plotësuar kështu kriteret të parashikuara në instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që trajtojnë çështje migratore, si deklarata universale e të drejtave të njeriut miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 1948, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile Politike e vitit 1966, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, hyrë në fuqi më 4 janar 1969, Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut e 3 shtatorit 1953, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 2.3.2005 etj.

- Strategjia Kombëtare për Migracionin (2005-2010), miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 19.11.2004. Kjo strategji, e hartuar me mbështetje të programit CARDS dhe në bashkëpunim me IOM Tirana, është një dokument i rëndësishëm strategjik migrator, i cili trajton migracionin në Shqipëri si motor zhvillimi, e cila përfshin zbatimin e rreth 132 masave ndërinstitucionale për një periudhë 5-vjeçare, 2005-2010.

- Plani Kombëtar për Migracionin, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 6.5.2005, në të cilin janë parashikuar 66 masa, të cilat synojnë forcimin e luftës ndaj migracionit të paligjshëm, përmbajnë elemente konkrete të trajtimit të migracionit, si një fenomen në shërbim të migrantit dhe vendit, me kanalizimin e dërgesave në para të emigrantëve në dobi të tyre dhe të vendit, forcimit të rolit të diasporës, rritjen e rolit të strukturave përkatëse në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve, riintegrimi i të kthyerve në vend, parandalimi i largimit të trurit, duke synuar tërheqjen e studentëve dhe emigrantëve të suksesshëm etj.

- Strategjia për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, 2010-2015, dhe plani i saj i veprimit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 461, datë 9.6.2010, e cila synon të garantojë kthim të suksesshëm të shtetasve shqiptarë nëpërmjet riintegrimit të qëndrueshëm të tyre në Shqipëri.

- Ligji nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 124, faqe 5479, datë 1.8.2008 dhe hyrë në fuqi në datën 1.12.2008, me anë të të cilit janë përcaktuar konceptet dhe përkufizimet mbi çështjet e migracionit, të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Republikën e Shqipërisë, kushtet për hyrje, qëndrim transitim dhe daljen nga Republika e Shqipërisë, lëshimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit dhe lejeve të punës për të huajt, kushtet e përgjithshme për refuzimin, largimin dhe dëbimin e të huajve, mbikëqyrjen dhe trajtimin e të huajve, mbledhjen dhe administrimin e të dhënave personale për të huajt në Republikën e Shqipërisë, integrimin e të huajve në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore, si dhe sanksionet ndaj të huajve apo subjekteve të tjera që merren me pritjen, punësimin, transportin, akomodimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë.



- Ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006 “Mbi emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi” (i ndryshuar). Ligji i mësipërm nuk ka përputhshmëri të drejtpërdrejtë me legjislacionin e BE-së, por në të janë përfshirë dispozita të rekomanduara nga BE-ja, si nga konventat ILO nr. 97 dhe 143, Konventa mbi Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë, Këshilli i Europës 1997 dhe Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre”. Subjekt i ligjit janë shtetasit shqiptarë që emigrojnë me motive punësimi.

- Ligji nr. 10 060, datë 26.1.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, faqe 209, datë 9.2.2009 dhe hyrë në fuqi më datë 24.2.2009. Me anë të këtij ligji janë rregulluar çështjet e kërkesave për azil në kufi dhe në thellësi, procedurat e azilit, bashkëpunimi në mes këtyre strukturave, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuësve etj.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 1.4.2009 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 74, datë 22.5.2009, faqe 3293, i cili përcakton kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që kërkohen për të hyrë me dhe pa vizë në Republikën e Shqipërisë, përcakton listën e vendeve që hyjnë me vizë dhe atyre që hyjnë pa vizë, si dhe përfaqësitë konsullore ku aplikohet për vizë, përcakton kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për aplikim për lejeqëndrim, vlerën e lejeve të qëndrimit etj., të harmonizuara këto me:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 6.5.2009 “Për miratimin e modelit, specifikimeve teknike dhe formatit të dokumenteve të udhëtimit për të huajt”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 11.6.2009, faqe 3662. Me anë të këtij akti, përcaktohen: modeli, specifikimet teknike dhe formati i kartës biometrike të identitetit për të huajt, pasaportës biometrike për të huajt dhe pasaportës biometrike të refugjatit, të gjitha këto të njëjta me elementet e sigurisë dhe atyre biometrike me dokumentet e udhëtimit për shtetasit shqiptarë, në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren 1030/2002 të Këshillit të Europës.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 493, datë 6.5.2009 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të vizës pullë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 18.6.2009, faqe 3940. Me anë të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave është miratuar modeli i vizës pullë sipas standardeve ICAO9303 dhe ISO/ICE 7810, si dhe është autorizuar MPJ-ja për prodhimin e saj dhe vënien në përdorim.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 6.5.2009 “Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës dhe të modelit të lejes së qëndrimit për shtetasit e huajt”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 18.6.2009, faqe 3940. Me anë të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave janë miratuar elementet e sigurisë, forma dhe modeli i lejes së qëndrimit biometrike për të huajt në Republikën e Shqipërisë në përputhje të plotë të standardeve ICAO9303 dhe ISO/ICE 7810, ISO 10373, ISO 7501-3, duke garantuar kështu pamundësinë e keqpërdorimit apo tjetërsimit të saj nga persona të ndryshëm nga mbajtësi.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 27.4.2009 “Për një shtesë në vendimin nr. 362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 81, datë 4.6.2009, faqe 3559, me anë të të cilit u mundësohet shtetasve të vendeve, të cilët hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë, nëse kanë në përdorim një vizë të vlefshme të tipit “C” ose tipit “D” *Schengen* me shumë hyrje-dalje apo një leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga një vend *Schengen*, të hyjnë dhe qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë pa pasur nevojë të pajisen me vizë nga autoritetet shqiptare.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1083, datë 28.10.2009 “Për ngritjen e qendrës së mbyllur dhe miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të saj”, për të huajt e parregullt në territor, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 4.12.2009, faqe 7287, i cili normon ngritjen dhe funksionimin e kësaj qendre, si dhe rregullon organizimin dhe drejtimin e qendrës, të drejtat dhe detyrimet e të huajit të ndaluar në qendër, aspekte të pranimit dhe akomodimit në qendër, rregullat gjatë qëndrimit në qendër, vizitat, asistenca dhe higjiena në qendër ku përfshihen asistenca mjekësore, asistenca juridike, asistenca sociale, koha e lirë dhe zhvillimi i përgjithshëm, ushqimi, rregullat e jetesës, regjimi disiplinor, siguria dhe rendi publik në qendër, si dhe aspekte të tjera administrative.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 16.10.2003 “Mbi mënyrën e licencimit dhe të funksionimit të agjencive private të punësimit”. Subjektet janë APP-të. Vendimi i Këshillit të Ministrave rregullon pjesëmarrjen e sektorit privat në fushën e punësimit dhe kushtet për marrjen dhe ripërtëritjen e licencës, si dhe detyrat dhe detyrimet e ndërsjella të MPÇSSH-së dhe APP-ve, duke e vendosur të parën në rolin e monitoruesit të veprimtarisë së APP-ve.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, me anë të të cilit rregullohet mënyra e licencimit dhe e funksionimit të agjencive private të punësimit APP.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 745, datë 7.11.2007 “Për planin e veprimit të remitancave”. Qëllimi është rritja e kanaleve të ligjshme të ardhjes së tyre, shfrytëzimi i dërgesave për zhvillimin ekonomik të vendit dhe kalimi i dora-dorshëm nga konsumi në investime, që prodhojnë të ardhura dhe krijojnë vende të reja pune.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” për A/NK (punëtorë ndërkuftarë)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 69, datë 21.5.2009, faqe 3123. Karakteristika kryesore e kësaj leje pune për punësim ndërkuftar është rikthimi në vendbanimin e tij të përhershëm, çdo ditë ose të paktën një ditë në javë, duke ruajtur vendbanimin në vendin e origjinës. Në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe, i huaji që pajiset me leje pune të tipit “A/NK” i nënshtrohet legjislacionit vendas të mbrojtjes shoqërore. Kjo leje pune është e ripërtëritshme nëse nuk ndryshojnë kushtet kryesore, për të cilat është lëshuar leja paraardhëse.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për A/PS (punëtorë stinorë)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 69, datë 21.5.2009, faqe 3133.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 12.8.2009 “Për miratimin e marrëveshjes dhe të protokollit zbatues të saj, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, në fushën e punës”. Ky vendim miraton marrëveshjen dhe protokollin zbatues ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Italisë në fushën e punës”.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 1.4.2009 “Për një shtesë në vendimin nr. 296, datë 6.5.2005, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 68, datë 20.5.2009, faqe 3093 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit të strategjisë kombëtare të migracionit” (të ndryshuar)”. Ky vendim amendon vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 6.5.2005 dhe ngarkon Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me detyrën për të ngritur komitetin teknik për migracionin për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të planit kombëtar të veprimit të migracionit.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 22.5.2009, faqe 3161 “Për A/SH (shërbime vullnetare)”. Të



huajt, që ndjekin veprimtari si persona të punësuar, në kuadër të shkëmbimeve rinore, pajisen me leje pune, pa mbajtur parasysh zhvillimet dhe nevojat e tregut të punës në Republikën e Shqipërisë, pas testimit të vendit të lirë të punës. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së kësaj leje pune është deri në një vit, me përjashtim të rasteve, kur legjislacioni i Republikës së Shqipërisë në fuqi e parashikon ndryshe.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 22.5.2009, faqe 3172 “Për B/VP (veprimtari të pavarur ekonomike si i vetëpunësuar)”.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për A/AF (anëtarë të familjes)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 22.5.2009, faqe 3183.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për A/S (studentë)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 22.5.2009, faqe 3197.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për raste të veçanta “tipi C””, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 22.5.2009, faqe 3208. Të huajt i jepet leje pune për raste të veçanta, deri në një vit, kur bën pjesë në një apo më shumë nga kategoritë e përcaktuara në nenin 60 të ligjit për të huajt nr. 9959, datë 17.7.2008, geramat “a”-“g”.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për B/I (veprimtari të pavarur ekonomike si investitor)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 22.5.2009, faqe 3219.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për A/TN (të transferuarit brenda ndërmarrjes)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 22.5.2009, faqe 3233.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 357, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për leje pune të vazhdueshme tipi D”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 22.5.2009, faqe 3244;

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” për A/FP (arsimin profesional)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72, datë 22.5.2009 faqe 3254.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 359, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” për punëmarrës A/P”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, datë 22.5.2009, faqe 3269.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 6.3.2009 “Për dokumentacionin dhe procedurën për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, datë 22.5.2009, faqe 3280.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 29.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes të tipit C/SP (për sportistë)”.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 6.7.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen e anulimin e lejes së punës së tipit C/PSH (për punëtorë shtëpiakë)”.

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 10.11.2010 “Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papuna femra”” (i ndryshuar).

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 923, datë 10.11.2010 “Për një shtesë në vendimin nr. 48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë në vështirësi””, të ndryshuar.

- Udhëzimin e përbashkët të MB-së nr. 2864, datë 30.9.2009, të MPJ-së nr. 11 766, datë 6.10.2009 dhe MPÇSSH-së nr. 1857, datë 16.10.2009 për miratimin e planveprimit “Për implementimin e ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 për të huajt”, me anë të të cilit planifikohen një sërë masash për t’u kryer, si masa të plotësimit të kuadrit nënligjor, masa organizative, masa për përmirësimin e teknologjisë së informacionit dhe masa për trajnimin e personelit dhe, gjithashtu, plani i veprimit përfshin një numër të madh aktivitetsesh, institucionet përgjegjëse dhe ato bashkëpunuese, afatet e kryerjes së këtyre aktiviteteve, si dhe kostot e planifikuara për kryerjen e tyre.

- Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2102, datë 3.8.2009 “Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit të vizave”, me anë të të cilit janë përcaktuar qartë jo vetëm aktivitetet e secilës strukturë, por dhe mënyra e bashkëpunimit të tyre, radha e veprimeve, afatet e dërgimit të kërkesës për informacion dhe të kthimit të përgjigjeve, lloji i informacionit që kërkohet, mënyrat e komunikimit etj.

- Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2947, datë 6.10.2009 “Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e trajtimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë” me anë të të cilit përcaktohen bashkëpunimi i këtyre strukturave në procedurat e përgjithshme të kontrollit në hyrje në Republikën e Shqipërisë, në procedurat për pajisjen me leje qëndrimi të të huajve me qëndrim të ligjshëm, në procedurat e përzgjedhjes së të huajve të parregullt, në procedurat e ripranimit dhe ndalimit në qendrën e mbyllur për të huajt e parregullt etj.

- Udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 612, datë 29.3.2004 “Për mënyrën e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencimin e agjencive private të punësimit”.

- Urdhrin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 1722, datë 18.9.2007 “Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit”.

- Urdhrin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2086, datë 13.11.2007 “Për formën, përmbajtjen e regjistrimit për emigrantët dhe procedurat e regjistrimit”.

- Urdhrin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 1176, datë 3.6.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e komitetit teknik për migracionin”.

- Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1111, datë 29.9.2009 “Mbi koordinimin dhe bashkëpunimin brenda strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, bashkëpunimin e këtyre strukturave me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit, si dhe me struktura dhe aktorë të tjerë jashtë Policisë së Shtetit në kuadrin e zbulimit të imigracionit të paligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë”, me anë të cilit përcaktohet metodologjia e zbulimit të migracionit të paligjshëm në territor.

- Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1016, datë 8.9.2009 “Mbi funksionimin e zyrës së analizës së riskut dhe kimit ndërkuftar në departamentin për kufirin dhe migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe rregullimin e bashkëpunimit për



këtë qëllim me strukturat e tjera”, me anë të të cilit përcaktohet metodika e analizës së rrezikut në nivel strategjik, taktik dhe operacional, si dhe përcaktohen autoritetet përgjegjëse për analizën e rrezikut etj.

- Urdhri nr. 1727, datë 26.8.2010 “Për sekretariatit teknik për monitorimin e zbatimit të strategjisë për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer, 2010-2015, dhe planit të veprimit të saj”.

- Urdhri nr. 1999, datë 13.10.2010 “Për një shtesë në urdhrin nr. 782, datë 4.4.2006 “Për tarifën e sistemit të formimit profesional”.

- Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 17, datë 29.6.2010.

- Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 26, datë 10.8.2010 “Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2010-2011”.

- Programin e kurrikulës për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë nr. 6337 prot., datë 6.10.2010.

F.1.2 Përshkrim i shkurtër i aktorëve institucionalë kyç të përfshirë në menaxhimin e migracionit dhe diasporës

F.1.2.1 Niveli qeveritar

Në nivel qeveritar nuk ka një strukturë koordinuese apo lider mbi migracionin. Struktura qeveritare dhe organe të tjera shtetërore, si dhe të drejtat dhe obligimet e ministrive përkatëse janë të shprehura në thelb të Kushtetutës Shqiptare dhe akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore. Me një vendim të Këshillit të Ministrave, MPCSSHB-ja është emëruar si institucion lider për koordinimin e aktiviteteve për implementimin e strategjisë së migracionit dhe planit të saj të veprimit, ndërkohë që Ministria e Brendshme është përgjegjëse për menaxhimin e pjesës më të madhe të fushave të migracionit.

F.1.2.2 Niveli ndërinstitucional

Ministria e Brendshme është përgjegjëse kryesore për parandalimin dhe luftën e migracionit të paligjshëm nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve; kontrollit të të huajve në procedurat e aplikimit për vizë për të hyrë në Republikën e Shqipërisë, kjo në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të MPJ-së dhe SHISH-it; të kontrollit kufitar mbi kushtet dhe kriteret për të hyrë, qëndruar dhe transituar në Republikën e Shqipërisë; për pajisjen e të huajve me leje qëndrimi; për kontrollin e ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit vullnetar, largimit me forcë, dëbimit, ndalimin e të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës apo në vendin transit nga kanë ardhur; për zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit me vendet e tjera; për pritjen, intervistimin dhe përzgjedhjen e shtetasve të kthyer në kufi, si dhe informimin e tyre mbi mundësitë e riintegrimin në vend; për bashkëpunimin rajonal dhe më gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e paligjshëm dhe paralajmërimin e hershëm; për identifikimin dhe trajtimin e viktimave të qenieve njerëzore në bashkëpunim me strukturat e tjera nën autoritetin e koordinatorit kombëtar pranë këtij institucioni; për luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore, për azilin dhe shtetësinë etj.

Strukturat e MB-së që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e MB-së në fushën e migracionit janë: Policia e Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin²³, Departamenti kundër Krimit të Organizuar dhe kundër Krimeve të Rënda), Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme etj.

Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së vizave, si dhe negociimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit. Gjithashtu, MPJ-ja është përgjegjëse për mbështetjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare, bashkërendimin e

²³ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.5 të këtij materiali.
3498

veprimeve me strukturat e MB-së për ripranimin e shtetasve shqiptarë etj.

Strukturat e MPJ-së, që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e MPJ-së në fushën e migracionit janë: Drejtoria e Çështjeve Konsullore, Drejtoria e Traktateve dhe Çështjeve Ndërkombëtare, Instituti i Diasporës *institutdiaspora@mfa.gov.al*, ambasadat dhe postet konsullore jashtë vendit etj.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me emigracionin dhe imigracionin e punës; monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive të agjencive private të punësimit; përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë; hartimin dhe miratimin e programeve aktive dhe pasive të punësimit dhe formimit profesional në vend, për emigrantët e rikthyer me probleme ekonomike; koordinimin e procesit të informimit për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë në mënyrë të rregullt, si dhe ata që rikthehen e dëshirojnë të riintegrohen dhe qëndrojnë në Shqipëri; sigurimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, si dhe mbështetjen për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike, për emigrantët e rikthyer; koordinon dhe monitoron zbatimin e planit kombëtar të veprimit për migracionin; koordinon dhe monitoron zbatimin e masave të planit të veprimit të strategjisë për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer 2010-2015.

Strukturat e MPCSSHB-së që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e MPCSSHB-së në fushën e migracionit janë: Drejtoria e Politikave të Migracionit, Kthimit dhe Riintegrimit, Drejtoria e Politikave të Punësimit, Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale dhe drejtoritë e tjera brenda këtij institucioni. Krahas tyre, rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave të migracionit kanë: Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe zyrat rajonale e vendore të punësimit, në të cilat ndodhen edhe sportelet e migracionit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e shtetasve të huaj në Shqipëri në fushën e arsimit, kulturës dhe shkencës, si dhe për krijimin e kushteve për arsimimin dhe edukimin e emigrantëve shqiptarë në vendet ku ata ndodhen, në gjuhën amtare.

Instituti i Statistikave (INSTAT) është përgjegjës për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen dhe publikimin e statistikave në fushën e migracionit. Ky institut kryen anketime dhe prodhon raporte mbi situatën e migracionit në vend.

F.1.2.3 Aktorë të tjerë në fushën e migracionit në vend

- Aktorët ndërkombëtarë

Zyra e KB-së në Shqipëri (www.un.org.al), nëpërmjet një numri të konsiderueshëm organizatash në Shqipëri mbështet direkt çështjet e migracionit.

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) www.albania.iom.int, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse shtetërore shqiptare dhe ato të shoqërisë civile kontribuojnë në implementimin e strategjisë kombëtare të migracionit dhe planit të saj të veprimit, dokumente të rëndësishme mbi migracionin të përgatitura, gjithashtu, me kontributin e zyrës së IOM-së në Tiranë.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse shtetërore shqiptare dhe ato të shoqërisë civile kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit në fushën e punësimit, trajnimit e stafeve, ndërgjegjësimin e popullatës, mbështetjen e viktimave të trafikimit me procesin e riintegrimit të tyre etj.

UNHCR, <http://www.unhcr.org.al/>, bashkëpunon me institucionet përgjegjëse shtetërore shqiptare për të mbrojtur dhe ndihmuar azilkërkuessit dhe refugjatët. Ky bashkëpunim nënkupton monitorimin e procedurave për përcaktimin e statusit të refugjatit që kryhet nga qeveria, gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për personat e përcaktuar si refugjatët dhe akomodimin e përkohshëm të tyre, kryesisht në Qendrën Kombëtare të Pritjes.



Shërbimi Social Ndërkombëtar (ISS), <http://www.iss-ssi.org>, është një organizatë joqeveritare ndërkombëtare e angazhuar që të ndihmojë individë dhe familje që kanë probleme personale ose sociale, si rezultat i migracionit dhe lëvizjeve ndërkombëtare.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), www.osce.org/albania, mbështet autoritetet shqiptare dhe shoqërinë civile për të promovuar demokratizimin, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe për të konsoliduar institucionet demokratike në përputhje me parimet, standardet dhe angazhimet e OSBE-së, duke mbështetur kryesisht strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit nëpërmjet programeve të saj në fushën e sigurisë kufitare.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (PNUD/UNDP) www.undp.org.al mbështesin aspirimin e Shqipërisë për integrim në Europën e Bashkuar dhe kontribuon në përpjekjet kombëtare për të arritur objektivat për zhvillim të mijëvjeçarit. Për të identifikuar të metat në institucione dhe në sektorin publik, PNUD-i dhe Qeveria Shqiptare po bashkëpunojnë për të zhvilluar mekanizmat dhe stimujt e duhur për “rikthimin e trurit” dhe për angazhimin e diasporës në zhvillimin e vendit.

UNICEF, <http://www.unicef.org/albania/>, mbështet institucionet e qeverisë dhe ato të shoqërisë civile për të ngritur strukturat e nevojshme për të përmbushur të drejtat e çdo fëmije me anë të politikave sociale, mbrojtjes ligjore dhe informacionit; për të siguruar zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve, mbrojtjen e tyre nga trafikimi, abuzimi me substancë, dhuna dhe HIV/AIDS.

Delegacioni i Komisionit Europian në Shqipëri mbështet përpjekjet e qeverisë dhe shoqërisë shqiptare në procesin e ngritjes dhe zbatimit të një sistemi efektiv për migracionin, azilin, kthimet dhe ripranimet në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Misioni PAMECA në Shqipëri, asiston Policinë Shqiptare për rritjen e profesionalizmit dhe përmirësimin e aftësive drejtuese dhe menaxhuese, në interes dhe të menaxhimit të heshtjeve migratore.

USAID Albania, www.usaidalbania.org, mbështet migracionin me anë të programeve:

Veprimi i koordinuar kundër Trafikimit të qenieve njerëzore (CAAHT), <http://www.caaht.com/>, i cili përfaqëson një nga programet më të gjera në fushën e luftës kundër trafikimit në Shqipëri:

Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim dhe Hetim Kriminal (ICITAP) asiston Policinë e Shtetit dhe veçanërisht Policinë Kufitare dhe Migracionit në projekte për menaxhimin e integruar të kufirit dhe antitrafikimit; luftën kundër krimit të organizuar; përgjegjshmërinë policore dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; trajnimet dhe sistemet e menaxhimit të informacionit ku përfshihet edhe TIMS (Sistemi i Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit).

- Organizatat joqeveritare

Rrjeti “Të gjithë së bashku kundër Trafikimit të fëmijëve” (BKTF) është një koalicion organizatash ndërkombëtare dhe organizatash joqeveritare (OJQ). Koalicioni është i angazhuar në parandalimin e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri dhe kontribuon me ekspertizë ligjore dhe këshillim të përgjithshëm, <http://www.bktf-coalition.org.al>.

“Qendra për iniciativën ligjore për gratë” është projekt i shoqatës së grave juriste, e cila u jep mbështetje ligjore viktimave të trafikimit dhe të dhunës, i ndërgjegjëson ato për shkaqet dhe efektet negative të trafikimit të qenieve njerëzore dhe trajnon punonjësit lokalë të zbatimit të ligjit në Shqipëri. Tel.: +355 4 259795.

“Të ndryshëm dhe të barabartë” është një nga strehët më afatgjata në Tiranë për viktimat e trafikimit. Kjo strehë ofron shërbime të drejtpërdrejta riintegrimi për viktimat e trafikimit. Angazhimi i saj për riintegrimin, akomodimin dhe shërbime të tjera u japin mundësi vajzave të reja, që kanë vuajtur pasojat e trafikimit, të rifitojnë dinjitetin dhe të rindërtojnë një jetë normale. *Email: different&equal@icc.al.org*.

“Shoqata shpresë për të ardhmen” ofron ndihmë që nga viti 1999, për riintegrimin e migrantëve të kthyer. Kjo ndihmë konsiston në mbështetjen për punësimin e tyre nga kompani private, trajnime profesionale, kurse të gjuhëve të huaja, kurse për kompjuter, si dhe shumë shërbime të tjera me karakter social: www.shprese.org.

“Vizioni tjetër”, e financuar nga projekti CAAHT (veprime të koordinuara kundër trafikimit njerëzor) drejton një qendër rezidenciale, një çerdhe ditore për komunitetin dhe siguron apartamente për të miturit që janë në vështirësi, ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit. Misioni i shoqatës është të mbrojë të drejtat e njeriut dhe të rrisë ndërgjegjësimin për grupet në nevojë në Shqipëri.

“Qendra psikologjike “Vatra”” është e angazhuar në luftën kundër trafikimit të grave për shfrytëzim seksual nëpërmjet një sërë aktiviteteve, si: rritja e ndërgjegjësimin të publikut dhe kryerja e studimeve për statusin social të grave në Shqipëri dhe trafikimit të qenieve njerëzore, duke ofruar shërbime, si këshillime për femrat e trafikuar në qendrën psiko-sociale “Vatra”: *email: Q.P.S-Vatra@aul.sanx.net*.

F.2 Analizë e çështjeve të koherencës të politikave

- Koordinimi i politikave

Institucionet përgjegjëse për trajtimin e aspekteve të ndryshme të migracionit në Republikën e Shqipërisë, të listuara në seksionin (F1.3) të këtij profili, janë përgjegjëse për implementimin e politikave të veçanta migratore, pjesë përbërëse të politikës së përgjithshme migratore, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore me anë të të cilave është rregulluar politika migratore në Republikën e Shqipërisë.

Megjithëse nuk ka një strukturë të mirëfilltë në nivel qendror, që të koordinojë të gjitha aspektet e politikës migratore, ky koordinimi është mundësuar:

Së pari, nëpërmjet emërimit nga Këshilli i Ministrave të një institucioni përgjegjës për të koordinuar implementimin e strategjive ekzistuese në fushën e migracionit dhe planeve të tyre të veprimit.

Së dyti, nëpërmjet përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore të mënyrës së koordinimit të veprimtarive të institucioneve përgjegjëse për trajtimin e të huajve, të azilit dhe shtetësisë apo në fushën e emigrimit të shtetasve shqiptarë.

Gjithashtu, si institucionet përgjegjëse për koordinimin e implementimit të strategjive ekzistuese në fushën e migracionit dhe planeve të tyre të veprimit, si veprimtaria e koordinuar në mes institucioneve përgjegjëse për trajtimin e të huajve, azilit dhe shtetësisë, si dhe ajo në fushën e emigrimit të shtetasve shqiptarë, është gjithmonë e autorizuar të koordinohet dhe me aktorë të tjerë, si ndërkombëtarë ashtu dhe ata lokalë joqeveritarë, të angazhuar në fushën e migracionit. Koordinimi në mes strukturave shtetërore dhe organizmave ndërkombëtarë, si dhe atyre lokalë joqeveritarë është realizuar mbi bazën e memorandumeve të mirëkuptimit, marrëveshjeve të posaçme etj.

F.3 Bashkëveprimi ndërinstytucional dhe rajonal

F.3.1 Bashkëpunimi ndërinstytucional

Bashkëpunimi ndërinstytucional i strukturave shtetërore përgjegjëse në fushën e migracionit, është i parashikuar në strategjitë ekzistuese në fushën e migracionit, siç janë strategjia kombëtare mbi migracionin dhe plani i saj i veprimit (2005-2010), strategjia për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer (2010-2015), strategjia e menaxhimit të integruar të kufijve dhe plani i saj i veprimit (2008-2013), si dhe është rregulluar me anë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e migracionit.

Në fushën e vizave, përveç përcaktimeve ligjore mbi bashkëpunimin ndërinstytucional në këtë aspekt, me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2102, datë 3.8.2009 “Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe



Shërbimit Informativ Shtetëror, për procedurat e lëshimit të vizave”, janë përcaktuar qartë, jo vetëm aktivitetet e secilës strukturë, por dhe mënyra e bashkëpunimit të tyre, radha e veprimeve, afatet e dërgimit të kërkesës për informacion dhe të kthimit të përgjigjeve, lloji i informacionit që kërkohet, mënyrat e komunikimit etj.

Në fushën e hyrjes dhe qëndrimit të të huajve, të respektimit të ligjshmërisë dhe afateve të qëndrimit, të largimit të të huajve nga territori etj., përveç përcaktimeve ligjore mbi bashkëpunimin ndërinstitucional në këtë aspekt, me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2947, datë 6.10.2009 “Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e trajtimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë” është përcaktuar bashkëpunimi i këtyre strukturave në procedurat e përgjithshme të kontrollit në hyrje në Republikën e Shqipërisë, në procedurat për pajisjen me leje qëndrimi të të huajve me qëndrim të ligjshëm, në procedurat e përzgjedhjes së të huajve të parregullt, në procedurat e ripranimit dhe ndalimit në qendrën e mbyllur për të huajt e parregullt etj.

Përveç aspektit ligjor, bashkëpunimi ndërinstitucional është parashikuar dhe mundësuar, gjithashtu, të jetë i automatizuar dhe *on-line* në mes të gjitha strukturave përgjegjëse në fushën e imigracionit.

Me anë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe SHISH-it “Mbi ndërtimin dhe funksionimin e regjistrimit elektronik kombëtar për të huajt” nr. 1909/1, datë 12.2.2010 është parashikuar që institucionet përgjegjëse të hedhin dhe konsultojnë *on-line* informacionin mbi lejet e punës, mbi lejet e qëndrimit, mbi vizat, mbi hyrje-daljet në kufi, mbi masat administrative të marra ndaj të huajve me anë të të cilave kufizohet apo ndalohet hyrja në Republikën e Shqipëri, mbi azilin, si dhe viktimat e trafikut të qenieve njerëzore. Regjistri elektronik kombëtar për të huajt është në proces zhvillimi, ndërkohë që pjesa më e madhe e moduleve të tij janë tashmë funksionale. Në të ardhmen, regjistri parashikohet që t’u mundësojë shërbimeve përgjegjëse informacion në formën e alerteve për të gjithë të huajt, të cilët shkelin afatet ligjore të qëndrimit, si dhe prodhimin e raporteve dhe statistikave sipas standardeve të EUROSTAT-it.

F.3.2 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i Shqipërisë në fushën e migracionit është i gjerë dhe është konkretizuar pothuajse në të gjitha fushat apo përbërësit e politikës migratore.

Ky bashkëpunim është realizuar si në mënyrë direkte dy- apo shumëpalëshe, ashtu dhe nën anëtarësimin në nisma të përbashkëta apo bashkëpunimit në nisma të ndryshme rajonale apo më gjerë.

Bashkëpunimi rajonal dhe ai ndërkombëtar është rregulluar me anë të traktateve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e emigracionit apo atyre specifike me ndikim në çështje të veçanta të migracionit, të njohura nga Republika e Shqipërisë, me anë të marrëveshjeve dhe protokolleve dy- ose shumëpalëshe, me anë të memorandumeve të mirëkuptimit, deklaratave të përbashkëta politike në fushën e migracionit etj.

- Traktatet ndërkombëtare

Shqipëria ka njohur dhe është pjesë e disa konventave ndërkombëtare me ndikim direkt në fushën e migracionit, si:

- Konventa nr. 97 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për migracionin për punësim” 1949, ratifikuar me ligjin nr. 9320, datë 25.11.2004.

- Konventa për Statusin e Refugjatëve 1951, aderuar me dekretin nr. 200, datë 3.6.1992 të Presidentit të Republikës.

- Konventa ndërkombëtare “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racia” 1966, e ratifikuar në 11.5.1994.
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike 1966, aderuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991.
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore 1966, aderuar me ligjin nr. 7511, datë 8.8.1991.
- Konventa nr. 143 “Për punëtorët migrantë (dispozita plotësuese), 1975, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”, ratifikuar me ligjin nr. 9564, datë 19.6.2006.
- Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” 1979, aderuar me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993.
- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve të tjera ose dënimeve çnjerëzore johumane dhe degraduese 1984, ratifikuar në 11.5.1994.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve 1989, ratifikuar më 27.2.1992.
- Konventa Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”, aderuar me ligjin nr. 9703, datë 2.4.2007.
- Protokollin kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar 2000, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002.
- Konventa nr. 151 “Marrëdhëniet e punës (shërbimi publik)” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, aderuar me ligjin nr. 8426, datë 7.12.1998.
- Protokollin për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar 2000, ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002.
- Konventat e Këshillit të Europës
- Konventa europiane “Për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore”, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, 2005, e ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.
- Konventa Europiane “Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë”, ratifikuar me ligjin nr. 9555, datë 8.6.2006.
- Konventa në mes vendeve të Europës Juglindore:
- Konventa e bashkëpunimit policor në mes vendeve të Europës Juglindore, nënshkruar më 5 maj 2006, ratifikuar me ligjin nr. 9604, datë 11.9.2006.
- Marrëveshjet bilaterale
- Shqipëria ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve në fushën e ripranimeve, lëvizjes së ndërsjellë të shtetasve, marrëveshje punësimi, marrëveshjeve të bashkëpunimit policor etj.²⁴
- Memorandume mirëkuptimi
- Gjithashtu, Shqipëria ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi në fushën e migracionit, si në atë të shkëmbimit të të dhënave statistikore dhe paralajmërimin e hershëm, të procedurave të kthimit të viktimave të trafikut, të bashkëpunimit policor etj.²⁵
- Protokolle zbatimi
- Në interes të zbatimit të marrëveshjeve të arritura, Shqipëria ka nënshkruar disa protokolle zbatimi, si në fushën e ripranimeve, të bashkëpunimit policor, të shkëmbimit të informacioneve etj.²⁶

²⁴ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.6 të këtij materiali.

²⁵ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.6 të këtij materiali.

²⁶ Shiko tabelat shtesë në aneksin II- I.2.6 të këtij materiali.



F.4 Vlerësim i përgjithshëm i kontekstit të politikave migratore

Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani i saj i veprimit 2005-2010, si dokumenti strategjik mbi migracionin është hartuar mbështetur në situatën aktuale, kur emigracioni, e veçanërisht ai i paligjshëm përbënin shqetësim, jo vetëm për strukturat përgjegjëse në Shqipëri për menaxhimin e migracionit, jo vetëm për Qeverinë Shqiptare, por dhe për vendet e BE-së dhe partnerët ndërkombëtarë. Në këto kushte, kjo strategji është fokusuar më shumë në kontekstin e politikave emigratore.

Viti 2010 është dhe viti i përfundimit të periudhës kohore të zbatimit të strategjisë kombëtare për migracionin dhe planit të saj të veprimit, 2005-2010. Hartimi i strategjisë së re mbi migracionin dhe një plani ambicioz veprimi, duhet të shërbejnë si një mundësi e mirë për të përafuar plotësisht politikën shqiptare migratore me atë të BE-së apo të shprehur në normativën dhe rekomandimet e BE-së në këtë fushë.

Politika migratore në Shqipëri, gjatë vitit 2010, ishte një ndër elementet më të vlerësuara në procesin e liberalizimit të vizave, vlerësim, i cili ndikoi në marrjen e vendimit pozitiv për liberalizimin e vizave për shtetasit shqiptarë me vendet e BE-së, nga 15 dhjetori 2010 e në vazhdim.

Migracioni shqiptar tashmë ka një tjetër dinamikë krahasimisht të ndryshme me periudhën kur u hartua strategjia e parë, lind nevoja që strategjia e re të ketë në fokus jo vetëm parandalimin e migrimit të parregullt nga Shqipëria, por dhe nxitjen e lidhjes migrim-zhvillim. Gjithashtu, është e nevojshme që kjo strategji të trajtojë edhe politikën specifike lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe largimin e të huajve nga territori shqiptar.

Politikat në fushën e migracionit në Shqipëri, krahas nevojave të veçanta për menaxhim në përputhje me natyrën specifike të këtij fenomeni në vend, janë të drejtuara edhe nga procesi i integritimit evropian, detyrimeve në kuadër të marrëveshjes së stabilizim-asociimit në fushën e migracionit, raportet progresive të Komisionit Evropian lidhur me progresin e bërë nga vendi ynë në fushën e migracionit etj.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm i politikës migratore për vendin tonë është dhe përmirësimi i politikave të migracionit të punës. Megjithatë liberalizimi i vizave krijon mundësi të lëvizjes së shtetasve shqiptarë pa kufizime shtrënguese, si detyrimi për të marrë viza hyrjeje afatshkurtra, ai nuk krijon mundësinë e punësimit të shtetasve shqiptarë në këto vende. Për këtë arsye është e rëndësishme, që nëpërmjet instrumenteve të ndryshme, si marrëveshjeve të punësimit, memorandumeve të mirëkuptimit me vendet e BE-së e më tej, të krijohen dhe të rriten mundësitë për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të punojnë në këto vende, për të punuar në mënyrë të rregullt në tregjet e tyre të punës.

G. VLERËSIMI I NDIKIMIT TË MIGRACIONIT DHE POLITIKAVE MIGRATORE NË ZHVILLIMIN SOCIALO-EKONOMIK

G.1 Impakti i emigracionit në zhvillimin socialo-ekonomik të vendit

- Ndikimi në fushën ekonomike

Padyshim që emigracioni ka një ndikim parësor në fushën ekonomike të vendit të origjinës. Kjo është dhe arsyeja që strategjia kombëtare e migracionit 2005-2010 e ka konsideruar dhe trajtuar migracionin = zhvillim.

Në kuptimin e gjerë, emigracioni ka ndikim direkt pozitiv në fushën ekonomike të vendit si rezultat i dërgesave në para të emigrantëve në vendin e tyre.

Dërgesat e emigrantëve kanë qenë dhe janë shumë të rëndësishme për ekonominë shqiptare në përgjithësi dhe familjet shqiptare në veçanti. Fakti që ato përdoren në mënyrë jo të dobishme nga përfituesit e këtyre dërgesave ka shumë ndikim në kualifikimin e rëndësishëm që ata kanë.

Rritja e importit të mallrave të konsumit, deficitin e madh tregtar gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit etj., provojnë përdorimin jo të dobishëm dhe efikas të një pjese të mirë të të ardhurave nga dërgesat e emigrantëve.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e dërgesave janë dërgesa sezonale, çka bën që dhe roli dhe rëndësia e tyre në ekonominë e vendit të mos jetë e vazhdueshme dhe e garantuar, por në varësi të sezoneve të punësimit në vendet e destinacionit.

Me gjithë rëndësinë e madhe që kanë dërgesat e emigrantëve në zhvillimin e jetës ekonomike të vendit, çështja shtrohet se sa do të vazhdojë ekonomia të mbahet apo ushqehet nga këto dërgesa. Treguesit e viteve të fundit tregojnë se ka një rënie të ndjeshme në prurjet e këtyre dërgesave në vend. Prandaj, përpara se ekonomia të përballet me një situatë kaq të papërshtatshme, detyra e institucioneve shtetërore është që të marrin masa se si të nxisin dërgimin e këtyre të ardhurave në vend, por nga ana tjetër të gjejnë forma të tjera për të përfituar nga emigracioni, siç është dhe maksimizimi i përfitimeve direkte nga kthimet e emigrantëve.

Në pamjen e parë duket se ekziston një kontradiktë në mes konceptit të kontributit pozitiv të dy të kundërtave, por në fakt, si emigracioni ashtu dhe kthimi kanë një impakt pozitiv në zhvillimin e ekonomisë së vendit.

Nëse flasim për kthimin e emigrantëve nënkuptojmë reduktimin dhe të dërgesave në para të tyre nga emigrimi. Kjo do të përbënte impaktin negativ të kthimeve në kuptimin e gjerë të ndikimeve të kthimit në fushën ekonomike.

Nga ana tjetër, kthimi nga emigrimi i shtetasve shqiptarë do të shoqërohej me transferimin e aftësive dhe njohurive të marra në vendet e destinacionit.

Punësimi i emigrantëve në ekonominë e zhvilluar të vendeve pritëse i pajis emigrantët me një kulturë të re të menaxhimit të njohurive mbi teknikat dhe teknologjitë e fundit, mbi etikën e punës, mbi profesione dhe zanate të munguara në tregun e punës në Shqipëri.

Ajo çfarë shpeshherë i mungon zhvillimit ekonomik të vendit, nuk është nevoja për para, nevoja për investime, por aftësia për t'i shndërruar investimet në fitimprurëse apo për të investuar në interes të zhvillimit ekonomik të vendit.

Shumë fusha të ekonomisë në vend, sot po mbulohen me shërbime apo thënë ndryshe me fuqi punëtore nga jashtë, pra me fuqi punëtore të siguruar nga imigrimi, jo sepse nuk ekziston fuqi punëtore e lirë në treg, por mungon fuqi punëtore e kualifikuar, nganjëherë dhe për punë jo dhe shumë të veçanta apo të kualifikuara.

Numri i madh i emigrantëve shqiptarë jashtë, shumëllojshmëria e punëve që ata kryejnë, shpërndarja gjeografike e tyre në pothuajse të gjitha vendet e Europës, por dhe më gjerë, siguron premisa që me anë të kthimit të emigrantëve në Shqipëri të importohet një kontribut me vlerë, i munguar në fuqinë punëtore të kualifikuar shqiptare.

Emigrimi shoqërohet me varfërimin e krahut të punës, pasi shumica e emigrantëve janë relativisht në moshë të re apo në moshën më të përshtatshme për të kontribuar në tregun e punës. Kthimi, ndërkohë do të sillte në vend fuqinë e re punëtore, aq të nevojshme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Emigrantët, në vendin e destinacionit ku ndodhen, në saje të aktivitetit të tyre, që në rastin e Shqipërisë tashmë nuk është më një emigracion i ri, por i konsoliduar prej 20 vitesh, nëse do t'i referohemi vetëm emigracionit pas viteve 1990, në më të shumtën e rasteve kanë krijuar dhe kapitalet e tyre financiare, por dhe në shumë raste kanë ngritur biznese të qëndrueshme në këto vende.

Kthimi i emigrantëve do të sillte automatikisht mundësinë e sjelljes së këtyre investimeve direkte në Shqipëri. Hartimi i politikave nxitëse të kthimit, por dhe të mbështetjes dhe favorizimit të këtyre investimeve, do të ishte në fakt politika e maksimizimit të impakteve pozitive të kthimit në fushën e ekonomisë.



Emigrimi i shtetasve shqiptarë jashtë vendit është shoqëruar shpeshherë me pamundësinë e punësimit të tyre në vendet ku kanë emigruar në profesionet e tyre, kryesisht të atyre të kualifikuar në vend. Kthimi i tyre do të sillte njëkohësisht kontributin e kualifikuar të munguar në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Një ndër problematikat më të shfaqura vitet e fundit ka qenë largimi i interesit të shtetasve shqiptarë për të punuar në fusha të ekonomisë, si: blegtori, bujqësi etj., si rezultat i mospagesës së mirë në këto fusha, por dhe i etiketimit si “punë të rëndomta” etj., ndërkohë që në vendet e destinacionit këto lloje punësh kanë qenë ato që kanë zënë përqindjen më të madhe, veçanërisht në Greqi e Itali.

Kthimi i shtetasve shqiptarë nga emigrimi do të shoqërohej me sjelljen e një kulture të re për punën, me një angazhim në fushat ekonomike, si: bujqësia dhe blegtorja, që në fakt janë dy nga mundësitë më të mira për zhvillimin ekonomik të vendit.

Kthimi i emigrantëve shqiptarë së bashku me kapitalet e tyre financiare dhe investuese, nxitja dhe mbështetja e investimeve të tyre direkt në fushën ekonomike të vendit, do të shoqërohej, gjithashtu, me hapjen e vendeve të reja të punës. Hapja e vendeve të reja të punës do të ulte tendencën për emigrim të fuqisë punëtore, do të rriste të ardhurat e një numri më të madh të shtetasve, pra do të kishte ndikim direkt në rritjen ekonomike të vendit.

Politika e riintegrit të të kthyerve është një komponent tjetër i rëndësishëm me anë të të cilit krijohen kushte të favorshme për të kthyerit, për t’u riintegruar në shoqërinë shqiptare dhe për të kontribuar më pas në zhvillimin e kësaj shoqërie.

Në këtë mënyrë, kthimi i emigrantëve është i lidhur me nevojën që shoqëria shqiptare të kontribuojë në riintegrimin tyre dhe nga ana tjetër të kthyerit të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Në kushtet e sotme, kur kriza globale ekonomike ka prekur më së shumti vendet ku kanë emigruar shtetasit shqiptarë, kur dërgesat monetare nga shtetasit shqiptarë kanë pësuar një rënie të konsiderueshme, e gjithë politika ndaj emigracionit duhet të fokusohet ndaj nxitjes dhe më pas mbështetjes së kthimeve me qëllim rritjen e impakteve pozitive nga kthimet.

Nëse emigrantët nuk po ndjejnë më atë klimë të përshtatshme për të punuar dhe jetuar në vendet ku kanë emigruar, ndërkohë që ekonomia vendase në veçanti dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi kanë nevojë për këtë kategori, krijimi i klimës së përshtatshme për të kthyerit, madje duke e nxitur dhe mbështetur këtë kthim do të ishte politika më e drejtë për të garantuar maksimizimin e impakteve pozitive nga kthimet.

Kthimi i trurit, do të ishte mundësia më e mirë, kontributi më i madh në maksimizimin e përfitimeve nga kthimi në fushën ekonomike.

Aktualisht, një numër i madh studiuesish shqiptarë, elitë shqiptare e punësuar jashtë vendit, përbëjnë kapacitetin më të madh njerëzor aq të munguar në Shqipëri.

Kthimi i kësaj elite, nëse nga njëra anë konsiderohet shumë e vështirë, politika e nxitjes së kthimit është shumë e thjeshtë: nxitjen e interesit për t’u kthyer nëpërmjet ofrimit të mundësive për ta, që të investojnë kapitalin e tyre, intelektual, profesional pse jo dhe financiar.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit XX, Shqipëria pati shkallën më të lartë të emigracionit në botë. Sipas shifrave të regjistrimit të popullsisë, një në pesë shqiptarë emigruan midis viteve 1990 dhe 2001. Në periudhën 1990-2003 “largimi i trurit” goditi rëndë Shqipërinë; afërsisht 45% e profesorëve dhe studiuesve të universiteteve u larguan, ashtu si dhe më shumë se 65% e mbajtësve të gradës PhD, që kishin mbaruar në Perëndim gjatë viteve ‘80. Mijëra universitarë të diplomuar u larguan gjithashtu. Ky kapital intelektual mund të bëhet një pasuri e çmuar për Shqipërinë, e cila po lëviz drejt një integrimi në Europën e Bashkuar.

Qeveria Shqiptare, me mbështetjen e PNUD-it në Shqipëri, në vitin 2006 hartoi programin “Brain Gain”, ku partnerë kryesorë brenda qeverisë janë: Kabineti i Kryeministrit, Departamenti i Administratës Publike të Ministrisë së Brendshme dhe Ministria e Edukimit.

Gjatë katër viteve të aktivitetit të tij (2006-2010), projekti ka synuar të zmbarsë “largimin e trurit” të Shqipërisë. Projekti ka mbështetur qeverinë në përgatitjen e politikave publike për proceset e mësipërme. Si rezultat i saj janë ndryshuar disa ligje me frymën e programit *Brain Gain*, duke ndihmuar procesin e kthimeve efektive dhe të pandërprera në Shqipëri. Në anën tjetër, Qeveria e Shqipërisë ka aprovuar nëpërmjet një dekreti të veçantë qeveritar (dekreti i Qeverisë Shqiptare nr. 600, datë 30 korrik 2008) planin e veprimit afatmesëm të programit *Brain Gain*. Që atëherë janë aprovuar tri dekrete të tjera qeveritare, me qëllim rregullimin dhe përmirësimin e punës së programit *Brain Gain*.

Nëpërmjet paketave nxitëse të programit *Brain Gain* janë mbështetur 25 individë në administratën publike dhe 110 në institucionet e arsimit të lartë. Me propozimin e programit dhe me mbështetjen e departamentit të administratës publike, është përmirësuar klima ligjore në favor të kandidatëve, të cilët janë diplomuar në universitetet përëndimore në rekrutimin e Departamentit të Administratës Publike. Kjo u bë në tri format e mëposhtme:

- Avantazhe në konkurrim për një pozicion;
- Shtesa financiare sipas nivelit të kualifikimit (kualifikimi master e më tej);
- Kredi me përqindje të ulëta për persona që kthehen në kuadër të kësaj skeme.

Si rrjedhim i drejtpërdrejtë i këtyre ndryshimeve, një person, i cili ka përfunduar studimet pasuniversitare jashtë vendit hyn në konkurrim për një pozicion me 20 pikë për nivelin master dhe 30 pikë për nivelin PhD. Kjo masë është e vlefshme për personat që kthehen brenda kornizës së programit dhe për ata që zgjedhin të konkurrojnë drejtpërdrejt për një pozicion në administratën publike.

Programi *Brain Gain* ka faqen e tij të internetit www.braingain.gov.al, të lidhur me Këshillin e Ministrave dhe Departamentin e Administratës Publike. Ka një bazë të dhënash në këtë faqe interneti, të përdoruesve/aplikantëve të regjistruar, e cila mbahet me qëllim që të harmonizohet kërkesa e institucioneve akademike shqiptare, administratës publike dhe sektorit privat me ekspertizë të ofruar nga diaspora shqiptare. Procesi i regjistrimit pritet të intensifikohet akoma më shumë pas disa përmirësimeve teknike të faqes së internetit dhe fillimit të fushatës publicitare për t’u regjistruar. Procesi do të jetë i lidhur ngushtë me njoftimin e vendeve të lira të punës në administratën publike. Tani janë të regjistruar pothuajse 500 individë me ekspertizë në fusha të ndryshme (300 gjatë vitit 2009) dhe 125 prej tyre janë kthyer dhe po punojnë në institucione të edukimit të lartë dhe të administratës publike në Shqipëri.

- Ndikimet në tregun e punës

Ndikimi i emigracionit në tregun e punës dhe në kushtet kur ky emigracion përbën një përqindje të konsiderueshme me raport me popullsinë dhe kur kategoria e emigrantëve janë 90% pjesa më aktive e tregut të punës, mund të veçohet si në aspektin afatshkurtër ashtu dhe afatgjatë.

Ndikimi i emigracionit në tregun e punës duhet shikuar në kontekst me shkallën e papunësisë në vend, si dhe ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit, që lidhen me perspektivën e tregut të punës për fuqi punëtore.

Ndërkohë që emigracioni mund të konsiderohet si fenomen negativ në tregun e punës, nga ana tjetër ai ka një ndikim pozitiv në aspektin afatshkurtër, pasi shoqërohet me rënie të papunësisë së popullsisë aktive. Efekti pozitiv i rënies së papunësisë (në mënyrë mekanike për shkak të emigrimit), përveç të tjerash qëndron dhe në faktin se reduktohen shpenzimet buxhetore për të paguar kategorinë e të papunëve. Megjithatë, në të njëjtën kohë që kemi reduktim të buxhetit për të mbuluar pagesën sociale për të papunët, si pasojë e uljes së numrit të papunësisë nga emigracioni, kemi dhe reduktim të të të ardhurave nga taksimi në buxhet, i ardhur për të njëjtën arsye, nga



emigracioni.

Përveç emigracionit të mirëfilltë, një ndikim në tregun e punës kanë dhe lëvizjet e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër të vendit, për motive punësimi ose i quajtur ndryshe “emigracioni i brendshëm”, i cili duhet analizuar në këndvështrimin e ndikimit në tregun e punës së bashku me emigracionin klasik drejt vendeve të tjera të destinacionit.

- Ndikimet në demografi

Emigracioni si lëvizje apo zhvendosje e popullatës nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit, apo ai i brendshëm si lëvizje e popullatës nga një zonë në një zonë tjetër, domosdoshmërisht shoqërohet me ndryshime në demografi.

Analizimi i ndikimeve në demografi i këtyre ndryshimeve për shkak të emigracionit, ndihmon për të përcaktuar përshtatjen e politikave të brendshme, si në terma afatshkurtër, por dhe afatgjatë, pasi kjo tablo e ndryshimeve pasqyron ndryshimet e momentit, por dhe trendin për të ardhmen.

Në bazë të këtyre ndryshimeve do të ndryshojë dhe planifikimi i zhvillimit të zonave të vendit, orientimi i investimeve, prioriteteve, shërbimeve ndaj komunitetit etj.

Emigracioni ka ndikim jo vetëm në ndryshimin e numrit të popullatës, por dhe të gjinisë, moshës, kualifikimit etj. Nganjëherë prishja e raporteve në mes gjinisë mund të ndikojë në elemente të tjera, si shtimi i popullsisë apo interesi për të qëndruar në një zonë banimi të caktuar.

Ndikimi i emigracionit në demografi mund të shkojë deri në prishjen e balancave rajonale dhe të kërkojë ndryshim (zgjerim apo zvogëlim) të njërive administrative të organizimit të sistemit të qeverisjes vendore.

- Ndikimi final

Ndikimi më i rëndësishëm i migracionit konsiderohet në rritjen e remitancave dhe përdorimi i tyre në mënyrë të drejtë në interes të zhvillimit ekonomik të vendit.

Zgjerimi i kanaleve të ligjshme të migracionit do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit edhe nëpërmjet zgjerimit të mundësive dhe kanaleve për sjelljen e investimeve direkte të huaja në vend, por dhe të diasporës.

Nxitja e migracionit të ligjshëm nga njëra anë, si dhe lufta kundër migracionit të paligjshëm nga ana tjetër, do të plotësojnë dy komponentët e domosdoshëm për ta shndërruar migracionin në zhvillim.

Të gjitha së bashku, përveç ndikimit në politikën e brendshme, do të kenë një ndikim direkt në politikën e jashtme, në elementin kyç të saj, atë të integritetit evropian.

G.2 Ndikimet e zhvillimit socialo-ekonomik në politikat migratore, si dhe format e tjera të ndikimit mbi migracionin

Migracioni është një dukuri e hershme në Shqipëri, ndërsa menaxhimi i migracionit apo politika migratore shqiptare është relativisht e re.

Zhvillimi i politikave migratore në Shqipëri, së pari, është diktuar nga nevoja e plotësimit të detyrimeve në kuadër të proceseve integruese euroatlantike të Shqipërisë, të nisura këto që nga hapja e negociatave për nënshkrimin e MSA-së, procesin e anëtarësimit në NATO, procesin e liberalizimit të vizave dhe, së fundmi, atë të plotësimit të kriterëve për anëtarësim të plotë në BE.

Me qëllim harmonizimit e politikës migratore në të gjithë komponentët e saj në përputhje me politikën migratore të BE-së, por dhe të rekomandimeve të BE-së, në përgjithësi për vendet që aspironin të anëtarësoheshin në BE dhe të rekomandimeve direkte për Shqipërinë nëpërmjet progresraporteve dhe vlerësimeve të ecurisë së arritjeve të Shqipërisë, në vitin 2005 u hartua strategjia kombëtare mbi migracionin dhe plani i saj i veprimit, 2005-2010.

Në interes të përmirësimit të normativës migratore në përputhje me *acquis communautaire*, nga viti 2005 dhe në vazhdim është punuar në përmirësimin e kësaj normative në përputhje me atë të BE-së, por dhe në interes të mbështetjes së zhvillimit socialo-ekonomik të vendit.

Kthimi i migracionit në zhvillim ka qenë motoja e politikës migratore për vitet 2005-2010. Ky objektivi është synuar të arrihet nëpërmjet maksimizimit të përfitimeve nga migracioni i ligjshëm, jo duke e nxitur, por duke e mirëmenaxhuar atë, si dhe nëpërmjet minimizimit të kostove nga migracioni i ligjshëm, duke e parandaluar dhe luftuar atë.

Shqipëria është një vend në të cilin shfaqen të gjitha dukuritë migratore, impaktet e të cilave ndjehen shumë shpejt, si në këndvështrimin pozitiv ashtu dhe atë negativ.

Në këto kushte, politika e zhvillimit socialo-ekonomik e vendit, por dhe politika të tjera, si: ajo e sigurisë, politika e integritetit etj., janë të lidhura ngushtë me politikën migratore në mbështetje, por dhe në interes të njëra-tjetrës.

H. KONKLUZIONE

H.1 Përfundimet më të rëndësishme në tendencat aktuale të migracionit

Gjatë vitit 2010 në Shqipëri, ashtu si dhe në vitet më parë, migracioni është shfaqur ose ka tentuar të shfaqet në të gjitha format e tij; në atë të emigracionit (të ligjshëm dhe të paligjshëm), si dhe imigracionit (të ligjshëm dhe të paligjshëm).

Shqipëria gjatë vitit 2010 ka qenë vend origjine i emigracionit të ligjshëm dhe të paligjshëm më së shumti drejt vendeve të BE-së, si vend destinacioni i imigracionit të ligjshëm dhe të paligjshëm, si dhe ka tentuar të përdoret dhe si vend transit i migracionit të paligjshëm.

Emigracioni shqiptar (megjithëse shifrat për të nuk janë shumë të sakta) përbën rreth 25-30% të popullsisë, shifër kjo shumë e lartë, ndërsa imigracioni në Shqipëri përbën vetëm 0.2% të popullsisë.

Emigracioni i paligjshëm shqiptar drejt vendeve të tjera, e kryesisht drejt vendeve të BE-së në vitin 2010, megjithëse shënoi një rënie me 25%, përsëri përbën rreth 1.3% të popullsisë.

Lidhur me moshën, në vitet 1990-2008 shumica e të huajve që jetonin në Shqipëri ishin ndërmjet të 30-ve dhe 50-ve. Për periudhën 2008-2010 vërehet një rritje e grup-moshës 25-30 vjeç.

Për sa i përket gjinisë së shtetasve të huaj rezidentë, vërehet se në vitin 2010 vazhdon të dominojë gjinia mashkullore me rreth 68%. Nisur nga statistikat, vërehet një rritje e përqindjes së femrave nga 18% në 32% të totalit të shtetasve të huaj rezidentë për vitin 2010.

Numri i azilkërkuesve megjithëse është dyfishuar në vitin 2010, në raport me vitet paraardhëse 2009 dhe 2008, përsëri nuk përbën ndonjë shifër shqetësuese (14 raste).

Imigracioni i paligjshëm vërehet se ka pasur një rritje në masën 20-30% gjatë vitit 2010, por kjo mund të jetë rezultat i përmirësimit të metodologjisë së zbulimit të imigracionit të paligjshëm në territor. Si pasojë e forcimit të masave për kontrollin e kushteve për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Shqipërisë, vihet re, gjithashtu, një rritje e numrit të refuzimeve të hyrjeve në kufi.

Gjatë vitit 2010, si pasojë e krizës financiare në vendet fqinje të BE-së, Greqisë dhe Italisë, e shoqëruar kjo me papunësi të theksuar në këto vende destinacioni për emigrantët shqiptarë, parashikohej një mungesë e theksuar në remitancat e shtetasve shqiptarë. Ndërkohë, nga frika e falimentimit të bankave në këto vende, ka rezultuar një reduktim i një deficiti të theksuar në remitancat e vitit 2010.

Kriza ekonomike në vendet e BE-së, ku më së shumti gjenden emigrantët shqiptarë (Greqi dhe Itali), papunësia e shkaktuar nga kjo krizë, mund të nxisë emigrantët shqiptarë të kthehen në Shqipëri me qëllim investimin e kapitaleve dhe eksperiencave të tyre, të fituara tashmë në një emigracion rreth 20-vjeçar.

Klima e favorshme e investimeve të huaja në Shqipëri, angazhimi i Qeverisë Shqiptare në një numër të madh projektsh kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme të transportit, ku në zbatimin e tyre janë të angazhuar kompani të huaja, pritet të rrisë në të ardhmen



numrin e imigrantëve legalë në Shqipëri.

Situatat e rënduara politike dhe konfliktet e armatosura në vendet e Afrikës Veriore, prezenca e një numri të konsiderueshëm të emigrantëve ilegalë të këtyre vendeve në Greqi, vend fqinj me Shqipërinë dhe me kufij tokësorë, pritet të sjellë rritje të konsiderueshme të rasteve të imigrantëve ilegalë, të cilët do të tentojnë të përdorin territorin e Republikës së Shqipërisë, si vend transit për të kaluar drejt vendeve të tjera të rajonit, e destinacion final vendet e ndryshme të BE-së, por dhe për të kërkuar azil si formë të përkohshme qëndrimi dhe mundësie për të vazhduar më pas emigrimin ilegal drejt vendeve të BE-së.

Liberalizimi i vizave për shtetasit shqiptarë pritet të ulë numrin e emigrantëve shqiptarë ilegalë në vendet e BE-së.

H.2 Përmirësimi i statistikave të migracionit

Menaxhimi i të dhënave mbi migracionin kërkon së pari standardizim në të gjitha proceset e menaxhimit të të dhënave, si” atë të grumbullimit, përpunimit, analizimit, shkëmbimit etj. nga të gjithë aktorët përgjegjës për menaxhimin e migracionit.

Përdorimi i standardeve jo të njëjta në përkufizimin e të dhënave dhe statistikave mbi migracionin, mungesat në mbledhjen e statistikave mbi emigracionin, diasporën, remitancat, por dhe statistikave të azilkërkuarve shqiptarë jashtë vendit, shkaktojnë probleme në menaxhimin në tërësi të të dhënave mbi migracionin.

Publikimi i të dhënave nga institucione apo organizma të paspecializuar, apo publikimi nga ato i të dhënave të pakonfirmuara nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, shpeshherë shkakton konfuzion në të kuptuarit e realitetit mbi situatat migratore.

H.3 Rekomandime lidhur me menaxhimin e statistikave mbi migracionin

Në interes të menaxhimit të unifikuar të statistikave mbi migracionin është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse për grumbullimin dhe përpunimin e tyre:

- Të standardizojnë të dhënat statistikore mbi migracionin në përputhje me kërkesat dhe standardet e EUROSTAT-it;

- Të zhvillojnë sistemet e teknologjisë së informacionit, sipas modeleve dhe kërkesave për të prodhuar në mënyrë automatike raporte dhe statistika;

- Të centralizojnë grumbullimin e të dhënave statistikore pranë autoritetit kombëtar përgjegjës për grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore INSTAT;

- Të kontribuojnë në përgatitjen e profileve kombëtare të zgjuara mbi migracionin, së paku një herë në vit, t’i miratojnë ato dhe t’i publikojnë në faqet e internetit të çdo strukture përgjegjëse për menaxhimin e migracionin, duke kontribuar kështu jo vetëm në orientimin e politikave të tjera kombëtare të lidhura me migracionin, por duke u ofruar të gjitha vendeve të tjera të dhënat statistikore mbi emigracionin e tyre në Shqipëri. Nëse një gjë e tillë do të bëhet nga të gjitha vendet, atëherë është gjendur zgjidhja e problemit që ekziston pak a shumë në të gjitha vendet; mungesa e të dhënave statistikore mbi emigracionin;

- Të bashkëpunojnë me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë të identifikuar si të angazhuar në çështjet e migracionit me qëllim analizimin e këtyre të dhënave dhe nxjerrjen e rekomandimeve.

I. ANEKSE

I.1 Burimet e përdorura për grumbullimin e të dhënave

1. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
2. Sistemi i statistikave INSTAT
3. Regjistri Kombëtar i të Huajve
4. Sistemi TIMS, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

I.2 ANEKS STATISTIKOR

I.2.1 Statistika mbi ndryshimet demografike

Popullsia më 1 janar/population on 1 Januar Tab. 1

Vitet	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Qytet	Fshat	/000
						Dendësia
1998	3061.5	1536.9	1524.6	1229.7	1831.8	106.5
1999	3049.2	1523.9	1525.3	1240.2	1808.9	106.1
2000	3058.5	1531.7	1526.8	1259.6	1798.9	106.4
2001	3063.3	1527.5	1535.8	1277.1	1786.2	106.6
2002	3084.1	1537.7	1546.4	1300.6	1783.6	107.3
2003	3102.8	1546.7	1556.1	1342.2	1760.6	107.9
2004	3119.5	1554.7	1564.8	1369.0	1750.6	108.5
2005	3135.0	1562.0	1573.0	1396.0	1739.0	109.1
2006	3149.1	1578.6	1570.5	1513.3	1635.8	109.5
2007	3152.6	1582.3	1570.3	1544.5	1608.1	109.7
2008	3170.0	1593.0	1577.0	1541.0	1629.0	110.3
2009	3193.9	1592.4	1601.5	1557.3	1636.6	111.1
2010	3195.0	1605.7	1589.3	1589.6	1605.4	111.1

Popullsia sipas grup-moshave më 1 janar

Tab. 2

Viti:	2008			2009			2010		
	Tot.	M	F	Tot.	M	F	Tot.	M	F
Deri 15	767449	398930	368519	756036.7	391758.7	364336.9	738829	386025	352804
15-60	2113452	1054111	1059341	2139428	1061694	1077714	2096685	1077455	1019230
60+	289149	135538	153611	298385.7	138918.7	159427.9	359458	142177	217281
Total	3170050	1588579	1581471	3193850	1592371	1601479	3194972	1605657	1589315

I.2.2 Statistika mbi investimet e kapitalit

Shqipëri. Bilanci tregtar për mallrat për vitet 2006-2010

Viti	Eksport				milion lekë	
	EU27	Vendet jo BE	Total	Azia	Amerika	
2006	68,598	6,930	75,528		1,460	372
2007	80,741	11,853	92,594		3,755	629
2008	89,675	17,812	107,487		4,453	451
2009	81,760	14,232	95,992		5,392	982
2010	113,710	32,149	145,859		10,550	2,755

Viti	Import				milion lekë	
	EU27	Vendet jo BE	Total	Azia	Amerika	
2006	195,836	52,164	248,000		39,059	7,684



2007	224,594	81,854	306,448	53,607	11,901
2008	267,182	82,972	350,154	69,416	15,662
2009	277,213	72,893	350,106	62,054	14,573
2010	298,040	79,132	377,172	63,081	14,731
Bilanci tregtar					
Viti	EU27	Vendet jo BE	Total	Azia	Amerika
					milion lekë
2006	-127,238	-45,234	-172,472	-37,599	-7,312
2007	-143,853	-70,001	-213,854	-49,852	-11,273
2008	-177,507	-65,160	-242,667	-64,963	-15,212
2009	-195,453	-58,661	-254,114	-56,662	-13,591
2010		-46,983	-231,313	-52,531	-11,976

- Indekset mesatare të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore

Viti i mëparshëm = 100

I.2.3 Statistika mbi punësimin e të huajve

- Lejet e punës lëshuar nga DPSHKP-ja, zyrat rajonale dhe vendore të punësimin


Organi lëshues	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujor i IV	Total 2010
Berat	3	-	4	-	7
Bulqizë	-	-	-	-	0
Delvinë	-	-	-	-	0
Devoll	-	-	-	-	0
Dibër	-	-	-	-	0
Durrës	9	14	14	31	68
Elbasan	32	9	36	13	90
Fier	9	-	28	5	42
Gjirokastër	6	2	6	2	16
Gramsh	-	-	-	-	0
Has	-	-	-	-	0
Kavajë	2	-	6	-	8
Kolonjë	-	-	-	-	0
Korçë	2	1	9	2	14
Krujë	-	21	6	2	29
Kuçovë	-	-	-	-	0
Kukës	-	-	-	-	0
Kurbin	4	1	-	1	6
Lezhë	7	11	4	1	23
Librazhd	-	-	5	-	5
Lushnjë	2	-	-	-	2
Malësi e Madhe	-	-	-	-	0
Mallakastër	-	-	-	-	0
Mat	14	-	-	3	17
Mirditë	-	-	-	-	0
Peqin	-	-	-	-	0
Përmet	-	-	-	1	1
Pogradec	-	2	-	1	3
Pukë	-	-	-	-	0

Sarandë	6	-	-	-	6
Shkodër	24	14	43	31	112
Skrapar	0	0	0	0	0
Tepelenë	2	-	-	-	2
Tiranë	164	225	229	189	807
Tropojë	-	-	-	-	0
Vlorë	9	4	11	6	30
DPSHKP	57	43	151	69	320
Totali	352	347	552	357	1608

Emërtimi	2006	2007	2008	2009	2010
Ushqime dhe pije joalkoolike	101.0	103.0	105.2	104.9	105.2
Pije alkoolike dhe duhan	105.5	109.6	102.2	103.5	105.5
Veshje dhe këpucë	97.3	99.0	97.1	98.0	98.5
Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji	105.1	104.4	103.9	101.7	103.6
Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	98.7	99.7	100.1	100.4	100.5
Shëndeti	103.4	99.5	101.0	103.2	106.9
Transport	103.4	100.5	107.6	97.9	104.7
Komunikimi	99.3	98.1	94.4	85.6	100.4
Argëtim dhe kulturë	100.9	99.4	101.9	107.0	100.2
Shërbimi arsimor	105.7	102.6	100.0	102.3	103.0
Hotele, kafene dhe restorante	102.4	103.5	103.5	102.0	101.3
Mallra dhe shërbime të ndryshme	101.1	100.3	101.0	100.8	101.6
Gjithsej	102.4	102.9	103.4	102.3	103.6

- Tabelën e shpërndarjes së lejeve të punës sipas tipit të lejeve të punës për shtetas të huaj:

Tipi i lejeve të punës	Nr. i lejeve të punës
A/P	1252
A/TN	102
A/NK	5
A/AF	2
A/PS	12
A/S	1
B/VB	129
B/1	25
D	18
C	62
Totali	1608






- Tabela e kategorizimit të lejeve të punës, sipas llojit të aktivitetit ku shtetasit e huaj janë punësuar


Aktiviteti		Nr. LP					
Industri nxjerrëse		150					
Industri përpunuese		33					
Industri ushqimore		36					
Industri kimike		26					
Industri e letrës, kartonit, botimet		14					
Industri kauçuku, plastike		3					
Prodhim, shpërndarja e energjisë elektrike e gazit dhe ujit		81					
Shëndeti dhe veprimtari sociale		115					
Shërbime shtëpiake		2					
Shërbime kolektive, sociale dhe personale		236					
Transporti dhe telekomunikacioni		89					
Tregtia dhe riparim automjetesh		228					
Hoteleri–restorant		28					
Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë		6					
Ndërtim		259					
Aktivitete financiare		13					
Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve		53					
Arsim		152					
Peshkim		10					
Bujqësi		7					
Industri e tekstileve dhe e veshjeve		36					
Industri e lëkurës dhe këpucëve		9					
Fabrikimi i drurit		6					
Fabrikim elektrike		0					
Prodhim		2					
Administrim publik		3					
Nxjerrja e produkteve joenergjitike		1					
Të tjera		10					
Shteti	Leje pune	Shteti	Leje pune	Shteti	Leje pune	Shteti	Leje pune
Argjentinë	3	Kinë	190	Gjermani	21	Rusi	9
Amerikë	29	Kili	2	Gjeorgji	0	Suedi	5
Angli	14	Kirgistan	1	Greqi	101	Serbi	30
Çeki	8	Kosovë	55	Indi	29	Siri	5
Australi	1	Kore	1	Norvegji	1	Slloveni	7
Austri	41	Kroaci	39	Iran		Spanjë	3
Brazili	2	Sllovaki	0	Itali	139	Turqi	567
Zelandë e Re	1	Qipro	1	Ukrainë	2	Poloni	4
Bosnjë	3	Mal i Zi	23	Jordani	3	Kazakistan	8
Bullgari	5	Maqedoni	61	Japoni	2	Zvicër	0

Danimarkë	0	Marok	0	Kanada	56	Portugali	1
Egjpt	16	Moldavi	1	Holandë	5	Nigeri	5
Filipine	54	Pakistan	2	Izrael	2	Ganë	1
Francë	12	Rumani	5	Hungari	11	Lituani	3
Finlandë	1	Liban	1	Senegal	1	Sri Lanka	1



Personat që janë pajisur me leje TP, sipas shtetësisë

Italianë	13
Holandezë	2
Gjermanë	2
Danezë	2
Irlandezë	1
Zviceranë	1
Amerikanë	1
Spanjollë	2
Suedeze	1
Austriakë	1
Rumunë	2
Turq	1
Kinezë	2
Azerbajxhanas	21
Filipinas	2
Egjiptianë	1
Kosovarë	8
Argjentinanë	1
Meksikanë	1
Iranianë	1



I.2.4 Statistika mbi nivelin e edukimit në Shqipëri

Specialitetet	2005	2006	2007	2008	2009
Gjithsej			8676	9425	13311
Studentë, diplomuar në publik:	5756	7630	8420	7689	9478
1. Universiteti i Tiranës	2400	2390	2892	3303	2806
2. Universiteti Politeknik	332	323	406	239	368
3. Universiteti Bujqësor	152	417	469	909	1073
4. Universiteti i Elbasanit	770	1548	1214	701	1344
5. Universiteti i Shkodrës	538	1142	813	347	735
6. Universiteti i Gjirokastrës	589	575	795	633	1015
7. Universiteti i Korçës	297	332	481	116	285
8. Universiteti i Vlorës	423	613	1067	1262	1546
9. Akademia e Arteve	142	182	166	179	179
10. Instituti i Kulturës Fizike	113	108	117	0	127
11. Shkolla e Lartë e Infermierisë	0	0	0	0	0
Studentë, diplomuar në privat:			256	1736	3833
1. Universiteti “New York”			81	53	54
2. Universiteti “Luarasi”			153	150	162
3. Universiteti “UFO Dental”					517
4. Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”				42	41
5. Universiteti “Marubi”			8	8	9
6. Universiteti “Marin Barleti”				8	38
7. Universiteti “Kristal”				1412	2837
8. Universiteti Europian i Tiranës					101
9. Universiteti “Aldent”			14	43	36
10. Universiteti “Medikadent”				20	38

I.2.5 Statistika mbi kthimet e shtetasve shqiptarë

Shtetet	Viti 2009	Viti 2010
1. Austria/Austri	25	19
2. Belgium/Belgjikë	152	84
3. Cyprus/Qipro		3
4. Czech Repulik/Republika Çeke	1	
5. Estonia/Estoni		
6. Finland/Finlandë	5	1
7. France/Francë	222	153
8. Germany/Gjermani	223	185
9. Greece/Greqi	62639	50735
10. Hungary/Hungari	29	85
11. Ireland/Irlandë	3	3
12. Italy/Itali	1444	1150
13. Latvia/Letoni	0	
14. Lithuania/Lituani	0	
15. Luxemburg/Luksemburg	10	1
16. Malta/Maltë	0	
17. Netherlands/Holandë	72	42
18. Poland/Poloni	5	4
19. Portugal/Portugali	1	2
20. Sllovakia/Sillovaki	2	1
21. Sllovenia/Silloveni	39	54
22. Spain/Spanjë	41	16
23. Sweden/Suedi	30	38
24. United Kingdom/Mbretëri e Bashkuar	524	340
25. Bullgari	5	
26. Rumani	12	1
27. Croatia	34	117
28. Bosnie-Hercegovina	31	
29. Serbia	22	5
30. Macedonia	1234	1004
31. Kosovo	129	106
32. Montenegro	135	49
33. Norway	40	18
34. Denmark	5	2
35. Island	3	1
36. Switzerland	347	229
37. Turkiye	48	4
38. USA	148	98
39. Canada	59	38
Totali	65484	52917



I.2.6 Aktorët institucionalë Shtrirja e departamentit për kufirin dhe migracionin



FIGURA 4: HARTA E

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Tiranë, ka në vartësi Komisariatin e Policisë Kufitare dhe Migracionit të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Rinas. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Tiranë, Elbasan, Peqin, Gramsh dhe Librazhd (vetëm për të huajt).

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Durrës, ka në vartësi Komisariatin e Policisë Kufitare Porti Detar Durrës dhe 4 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Durrës, Lezhë, Mirditë, Krujë, Kurbin, Kavajë dhe Lushnjë.

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Shkodër, ka në vartësi 5 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë.

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Kukës, ka në vartësi 6 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Kukës, Tropojë dhe Has.

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Dibër, ka në vartësi 4 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Dibër, Mat, Bulqizë dhe Librazhd (për mbikëqyrjen e kufirit).

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Korçë, ka në vartësi 6 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Korçë, Pogradec, Devoll dhe Kolonjë.

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë, ka në vartësi 3 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet.

- Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Vlorë, ka në vartësi Komisariatin e Policisë Kufitare Sarandë dhe 8 stacione të policisë kufitare dhe migracionit. Juridiksioni i kësaj drejtorie shtrihet në rrethet: Vlorë, Sarandë, Delvinë, Fier, Mallakastër, Berat, Kuçovë dhe Skrapar.

I.2.7 Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

**LISTA E MARRËVESHJEVE TË RIPRANIMIT DHE PROTOKOLLEVE TË ZBATIMIT TË
PROPOZUARA, TË NËNSHKRUARA DHE HYRË NË FUQI**

Nr.	Vendi		Nënshkruar		Statusi
	Anëtar BE	Kandidat ose jo	PO	JO	
1.	Italia Marrëveshja Protokoll me Italinë për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit me BE-në		Po (18.11.1997) Po (31.10.2008)		Hyrë në fuqi 31.10.2008
2.	Belgjika (marrëveshja dhe protokoll)		Po (17.4.2001)		Marrëveshja dhe protokollin kanë hyrë në fuqi më 1 nëntor 2004
3.	Republika Federale e Gjermanisë		Po (18.11.2002)		Marrëveshja ka hyrë në fuqi më 1.8.2003
4.	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (marrëveshja dhe protokoll)		Po (15.10.2003)		Marrëveshja dhe protokollin kanë hyrë në fuqi më 16.8.2005
5.	Hungaria (marrëveshje dypalëshe) Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Hungarisë për zbatimin e marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar, nënshkruar në Luksemburg, më 14 prill 2005		Po (20.4.2001) Po (30.10.2009)		Marrëveshja dypalëshe për ripranimi në personave me qëndrim të paligjshme në territoret e tyre shfuqizohet me hyrjen në fuqi të protokollit. Protokollin ka hyrë në fuqi më 16.4.2010
6.		Zvicra marrëveshja dhe protokoll)	Po (29.2.2000)		Marrëveshja dhe protokollin ka hyrë në fuqi më 2.1.2003.
7.	Bullgaria (Marrëveshja për ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë)		Po (11.6.2002)		Marrëveshja ka hyrë në fuqi më 2.1.2003
8.	Rumania (Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për ripranimin e personave) Protokollin i zbatimit të Marrëveshjes së ripranimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë, nënshkruar në Bukuresht		Po (7.6.2002) Po (13.10.2004)		Marrëveshja ka hyrë në fuqi (s'kemi të dhëna) Protokollin ka hyrë në fuqi më 23.5.2005
9.		Kroacia (marrëveshja) Protokoll)	Po (28.1.2003) Po (10.02.2009)		Hyrë në fuqi më 15.6.2005.
10.		Maqedonia (marrëveshja dhe protokoll)	Po (17.6.2004)		Hyrë në fuqi më 15.7.2005
11.		Moldavia		Jo	Marrëveshja është ende në proces (nuk ka ende përgjigje nga pala moldave)
12.		Bosnjë- Hercegovina	Po(23.3.2009)		Hyrë në fuqi më 1.4.2010
13.		Turqia		Jo	Pritet përgjigje nga autoritetet kompetente turke
14.	Sllovenia (protokoll ripranimi)		Po (20.10.2010)		3.6.2011
15.	Sllovakia (protokoll ripranimi)		Po (21.1.2010)		21.1.2010
16.		Norvegjia	26 gusht 2008		Hyrë në fuqi më 1.5.2009
17.	Austria (marrëveshja dhe protokoll)		PO (29.6.2007)		Hyrë në fuqi më 29.6.2007



18.	BE (Komuniteti Europian)	Po (14.4.2005)	Hyrë në fuqi më 1.5.2006
19.	Protokoll zbatimi i marrëveshjes së BE-së me Shtetet e Beneluksit (Mbretëria e Belgjikës, Dukatat të Madh të Luksemburgut, Mbretëria e Vendeve të Ulëta)	Po (9.6.2005)	Hyrë në fuqi më 6.3.2008 Krijimi i komisionit të përbashkët të ripranimit
20.	Danimarka	Po (24.4.2008)	1.12.2008
21.	Protokoll me Greqinë për zbatimin e Marrëveshjes së ripranimit me BE-ne	Jo	Pritet mendimi i palës greke për propozimin tonë
22.	Islanda (marrëveshje)	Po (26 gusht 2008)	Hyrë në fuqi më 1.1.2010
23.	Mali i Zi	Po (6.11.2009)	17.3.2010
25.	Franca (protokoll i ripranimit)	Jo	Pritet nënshkrimi. Miratuar në parim me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 8.4.2009
26.	Kosova	Po (6.10.2009)	Hyrë në fuqi më 12.3.2010
27.	Serbia	29.4.2010	Pritet të hyjë në fuqi
28.	Portugalia (protokoll)	JO	Protokoll i është negociuar nga palët

VENDIM
Nr. 409, datë 2.7.2012

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DENAS” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3/b, e 23, pika 3 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Denas” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali që i jepet shoqërisë “B.A.D.” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Denas”, të pranohet oferta për të gjithë pesën e lirë të pëllgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.7.2012
Doli nga shtypi më 4.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 70 lekë